

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6801
E premte, 13 janar 2023
çmimi 0.40 €

Shqipëria do të hapë
ambasadë në Ukrainë **FAQE 3**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

ZYRTARI I LARTË AMERIKAN: ASOCIACIONI, ÇËSHTJE URGJENTE **FAQE 4-5**



Këshilltari i lartë i Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, ka thënë se Kosova duhet t'i përmbushë të gjitha zotimet në kuadër të dialogut, përfshirë edhe

formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Në këtë drejtim ai ka theksuar se presin nga Qeveria e Kosovës të vendosë disa propozime në tryezë.

"Asociacioni është një çështje urgjente në agjendën e dialogut. Ka marrë një rëndësi edhe më të madhe pas ngjarjeve të fundit në veri", ka thënë Chollet

OPINION

**KOSOVA
E KA OBLIGIM
KUSHTETUES
KTHIMIN E
PRESIDENTIT
THAÇI NË ATDHE!**



F. 6

Shkruan: Sali BISLIMI

AKTUALE



**HUNGARIA PARALAJMËRON
PADI NDAJ KE-SË PËR SHKAK
TË FONDEVE PËR ARSIM F. 2**

**QEVERIA: NUK PËRJASHTOJMË
ASNJË SERB QË TË APLIKOJË
NË POLICINË E KOSOVËS F. 5**

EKONOMI



**FORUMI EKONOMIK BOTËROR:
DËMI MJEDISOR, INFLACIONI,
SIGURIA KIBERNETIKE, RREZIQET
PËR KOSOVËN F. 8**

**GJYSMA E EVROPIANËVE
THONË SE STANDARDI
I JETESËS SË TYRE KA RËNË F. 8**

SPORT



E LASHË SHKOLLËN PËR FUTBOLLIN

F.12

**KOMISIONI
I PE-së
MIRATON
LIBERALIZIMIN
E VIZAVE PËR
KOSOVËN **FAQE 7****



**HUMAN
RIGHTS
WATCH**

**HRW: NJË VIT PLOT
TENSIONE, KËRCËNIME
DHE SHKELJE TË TË
DREJTAVE TË NJERIUT **FAQE 3****

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Hungaria paralajmëron padi ndaj KE-së për shkak të fondeve për arsim

BUDAPEST, 12 JANAR - Qeveria e Hungarisë do të ndërmarrë veprime ligjore kundër krahut ekzekutiv të Bashkimit Evropian nëse nuk mund të arrihet marrëveshje për fondet e BE-së për programet universitare për studime jashtë vendit, tha një zyrtar hungarez. Duke folur në një konferencë për medie në Budapest, Gergely Gulyas, shef i stafit të kryeministrit, tha se vendimet e fundit të Komisionit Evropian për t'i ndërprerë fondet për programin e këmbimit të studentëve, Erasmus, në shumë universitete hungareze janë "të papranueshme dhe të patolerueshme". Gulyas shtoi se Qeveria e Hungarisë do të ofrojë financim

të programit nëse fondet e BE-së nuk arrijnë, por do ta dërgojë këtë rast në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë, nëse Budapesti dhe Brukseli nuk arrijnë një kompromis për këtë çështje. Ndërprerja e financimit, që do të prekte studentët hungarezë që studiojnë jashtë përmes programit të BE-së, Erasmus, por edhe financimin për hulumtime në shumicën e universiteteve hungareze, është pjesë e një serie të dënimeve që blloku ka vendosur ndaj Qeverisë hungareze, nga e cila po kërkon që të respektojë standardet për sundim të ligjit dhe demokraci. BE-ja ka lënë të kuptohet se sistemi i arsimit të lartë të Hungarisë që në vitin 2019 iu

nënshtrua ndryshimeve, të cilat bënë që kontrolli i universiteteve publike të kalonte në fondacionet, shpesh të udhëhequra nga politikanët nuk mbron si duhet lirinë akademike nga ndikimi politik. Gulyas insistoi se Hungaria ka bërë gjithçka që i është kërkuar nga Komisioni për të parandaluar konfliktin e interesit në udhëheqjen e institucioneve të arsimit të lartë. Megjithatë, ai tha se nëse Komisioni do të kërkojë që politikanët e lartë hungarezë të mos lejohen të jenë në bordet e universiteteve, Hungaria është e gatshme të modifikojë më tej rregullat e saj. BE-ja ka ngrirë më shumë se 12 miliardë euro fonde për Hungarinë, pas shqetësimeve se



kryeministri hungarez, Viktor Orban, ka përdorur fondet e bllokut evropian për të shkatërruar institucionet demokratike dhe për të pasuruar

aleatët e tij. Hungaria ka afat deri në mars që të zbatojë dhjetëra reforma në linjë me standardet e BE-së, në mënyrë që këto fonde të zhblokoohen.

Më shumë se gjysma e kompanive raportojnë mungesë të fuqisë punëtore



BERLIN, 12 JANAR - Më shumë se gjysma e kompanive gjermane po përpiqen t'i plotësojnë vendet e lira të punës për shkak të mungesës së punëtorëve të kualifikuar, thanë të enjten Dhomat Gjermane të Tregtisë dhe Industrisë (DIHK), shenja më e fundit që tregon krizën në një nga ekonomitë më të fuqishme të Evropës. Përqindja e kompanive që po përballesh me vështirësi në punësim është në nivelin më të lartë ndonjëherë, zbuloi Dhoma e Tregtisë në sondazhin me 22,000 kompani, ku 53 për qind që raportojnë mungesa. Mungesa e stafit, çmimet e larta të energjisë dhe zhvendosja drejt neutralitetit të klimës krijon tani një përzierje të

rrezikshme që mund t'i çojë firmat të zhvendosnin prodhimin jashtë vendit. "Mungesa e punëtorëve të kualifikuar nuk është vetëm një barrë për bizneset, por gjithashtu rrezikon suksesin në detyra të rëndësishme për të ardhmen si tranzicioni i energjisë, digjitalizimi dhe ndërtimi i infrastrukturës", vlerësohet në gjetjet. Sondazhi zbuloi se 67 për qind e prodhuesve të pajisjeve elektrike nuk ishin në gjendje të plotësonin vendet vakante, e po aq edhe në kompanitë në fushën e inxhinierisë mekanike. Në sektorin e prodhimit të makinave, 65 për qind e kompanive raportuan gjithashtu mungesë të fuqisë punëtore.

Ekipi i Bidenit raportohet se ka gjetur dokumente të tjera të klasifikuara

UASHINGTON, 12 JANAR - Ekipi ligjor i presidentit amerikan Joe Biden ka zbuluar dokumente shtesë, që janë të shënjuara si të klasifikuara. Dokumentet janë gjetur në një lokacion tjetër, tha një person për Associated Press, e cili ka njohuri me këtë çështje. Edhe mediet e tjera amerikane, përmes burimeve, kanë raportuar se janë gjetur dokumente shtesë. Njoftimi për gjetjen e dokumenteve të reja vjen disa ditë pasi avokatët e presidentit Biden zbuluan "një numër të vogël" të dokumenteve të

klasifikuara në ish-zyrën e tij në Uashington. Më herët gjatë kësaj jave, Shtëpia e Bardhë konfirmoi se Departamenti i Drejtësisë po shqyrtonte "një numër të vogël të dokumenteve të shënjuara si të klasifikuara" që ishin gjetur në zyrën të cilën më herët kishte përdorur Biden. Avokatët thanë se ato dokumente u gjetën në zyrën e Qendrës Penn Biden dhe menjëherë njoftuan Arkivat Kombëtare lidhur me zbulimin, tha Shtëpia e Bardhë. Biden e kishte përdorur këtë zyre pasi u largua nga posti i

nënpresidentit më 2017 dhe kishte qëndruar aty deri në momentin që kishte nisur fushatën presidenciale më 2019. Një person që foli për AP-në të enjten, tha se ekipi ligjor i presidentit gjeti materiale shtesë të klasifikuara në një lokacion të dytë. Ky person nuk ishte i autorizuar që të fliste publikisht për detajet e kësaj çështjeje të ndjeshme, prandaj ai foli në kushte anonimiteti. Ky burim nuk dha detaje se ku dhe kur u gjetën materialet, apo për nivelin e klasifikimit që kishin këto dokumente.



Komisioni i PE-së miraton liberalizimin e vizave për Kosovën

Diplomatët e Bashkimit Evropian kanë thënë se tashmë ka mbetur vetëm përmbyllja e pjesës formale të vendimit për heqjen e regjimit të vizave

PRISHTINË, 12 JANAR - Komisioni për Liritë Qytetare, Drejtësi dhe Çështje të Brendshme (LIBE) i Parlamentit Evropian, më 12 janar miratoi marrëveshjen për liberalizimin e vizave për Kosovën. Bëhet fjalë për marrëveshjen që është arritur në dhjetorin e kaluar në mes të Parlamentit, Këshillit dhe Presidencës së Bashkimit Evropian, që atëbotë udhëhoqej nga Republika Çeke. Vendimi u miratua në LIBE me 48 vota për, shtatë kundër dhe tri

abstenime.

Miratimi i marrëveshjes në këtë komision të PE-së dëshmon se normalizimi i vendimit të bllokut evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën po shkon sipas planit dhe procedurave përkatëse, ku përfshihen institucione të ndryshme të BE-së.

PE-ja ka caktuar deputetin socialist nga Holanda, Thijs Reuten, raportues të saj për dosjen që ka të bëjë me liberalizimin e vizave për

Kosovën.

Reuten disa herë ka deklaruar se Parlamenti Evropian do të punojë me shpejtësinë maksimale për këtë proces, i cili, siç ka thënë ai, veçse ka zgjatuar shumë. "Një hap më afër udhëtimit të shumëpritur pa viza për Kosovën", shkroi në rrjetet sociale Reuten, duke paralajmëruar se hapi i ardhshëm në PE do të jetë votimi në seancën plenare, ku duhet të votojnë të gjithë deputetët e Parlamentit.

Diplomatët e BE-së kanë thënë se tashmë ka mbetur vetëm përmbyllja e pjesës formale të vendimit, pasi Presidencë çeke me sukses e kishte përfunduar punën kryesore në dhjetorin e vitit të kaluar.

Përpjekjet e Presidencës çeke ishin kurorëzuar së pari me

pajtimin e shteteve të BE-së për liberalizimin e vizave për Kosovën. Ky vendim ishte kompromis, sipas të cilit, liberalizimi i vizave do të hyjë në fuqi së bashku me funksionalizimin e sistemit ETIAS, më së voni deri më 1 janar 2024.

Sistemi ETIAS kërkon që qytetarët e huaj, të cilët udhëtojnë pa viza në territorin e BE-së, t'i regjistrojnë të dhënat e tyre në këtë sistem para udhëtimit.

Pasi të gjitha shtetet anëtare ranë dakord për këtë vendim, Këshilli nisi negociatat me Parlamentin Evropian për ta formalizuar vendimin sipas procedurave të BE-së. Por, me insistimin e Presidencës çeke, mjaftoi vetëm një takim me përfaqësuesit e

Këshillit dhe Parlamentit që të arrihej marrëveshje për çështjen e vizave.

Tani ka mbetur që në strukturat punuese të Këshillit të përkthehet teksti i marrëveshjes në të gjitha gjuhët dhe të miratohet sërish nga ambasadorët, në mënyrë që më pas të paraqitet për konfirmim edhe një herë para Parlamentit Evropian.

Qytetarët e Kosovës janë të vetmit në rajonin e Ballkanit Perëndimor që nuk mund të lëvizin lirshëm në shtetet e BE-së.

Që nga viti 2018 Komisioni Evropian disa herë ka konfirmuar se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet për liberalizim, por vendimi nuk ishte marrë për shkak se disa shtete kishin shprehur rezerva.



Shqipëria do të hapë ambasadë në Ukrainë

TIRANË, 12 JANAR - Shqipëria së shpejti do ta ketë ambasadën në Kiev, në kryeqytetin e Ukrainës, njoftoi ministrja për Evropën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë, Olta Xhaçka, në kohën kur po shënohet 30-vjetori i vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve. "Shqipëria do ta mbështesë Ukrainën dhe popullin e saj me maksimumin e aftësive të saj derisa të triumfojë kundër luftës së paligjshme të agresionit të Rusisë. Shqipëria dhe Ukraina i përkasin familjes së kombeve të lira dhe demokratike dhe të dyja kanë një të ardhme në familjen euro-atlantike", ka shkruar Xhaçka në "Facebook".

Që prej 24 shkurtit të vitit 2022, kur nisi pushtimi rus i Ukrainës,



Shqipëria, anëtare e NATO-s që nga viti 2009, është rreshtuar me këtë aleancë ushtarake dhe me Bashkimin Evropian në mbështetjen e Ukrainës. Në

kuadër të kësaj mbështetje janë miratuar disa vendime, që lejojnë shtetasit e Ukrainës të hyjnë dhe qëndrojnë pa leje të qëndrimit në Shqipëri për një

periudhë njëvjeçare si dhe krijimin e një task-force për t'i menaxhuar aplikimet për mbrojtje ndërkombëtare për shtetasit që vijnë nga Ukraina.

Autoritetet shqiptare, gjithashtu, kanë përkrahur rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së që dënon pushtimin rus të Ukrainës dhe, së voni, kanë ndërmarrë një iniciativë për dokumentimin dhe hetimin e krimeve të luftës në Ukrainë përmes OKB-së.

Para fillimit të luftës dhe sanksioneve që u vendosën ndaj Rusisë, sipas të dhënave të Institutit të Statistikave (INSTAT), Shqipëria ka importuar mbi 40 për qind të totalit të drithërave nga Rusia, ndërsa 4 për qind nga Ukraina. Sipas ambasadës ukrainase në

Tiranë, që nga shkurti i vitit 2022 në Shqipëri janë strehuar afërsisht 3 000 shtetas ukrainas.

Më 3 maj të vitit që shkoi, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky iu drejtua me një fjalim online Kuvendit të Shqipërisë. Përveç falënderimit për mbështetjen, ai kërkoi t'u ndalohej hyrja në Shqipëri turistëve rusë.

Kjo kërkesë nuk u mor parasysh nga qeveria shqiptare.

Marrëdhëniet diplomatike mes dy vendeve janë vendosur më 13 janar 1993, ndërsa Ukraina ka hapur ambasadën e saj në Tiranë në shtator të vitit 2020.

Ambasador i saj është emëruar Volodimir Shkurov, i cili është ende në detyrë.

Në Ukrainë, në rajonin e Odesës, jetojnë rreth 3 500 shqiptarë.



Zyrtari i lartë amerikan: Asociacioni, çështje urgjente

Këshilltari i lartë i Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, ka thënë se Kosova duhet t'i përmbushë të gjitha zotimet në kuadër të dialogut, përfshirë edhe formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Në këtë drejtim ai ka theksuar se presin nga Qeveria e Kosovës të vendosë disa propozime në tryezë. "Asociacioni është një çështje urgjente në agjendën e dialogut. Ka marrë një rëndësi edhe më të madhe pas ngjarjeve të fundit në veri", ka thënë Chollet.

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

Prishtinë, 12 janar - Këshilltari i Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, ka theksuar se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe duhet të themelohet në pajtim me Kushtetutën e Kosovës dhe ai është një detyrim ligjor.

Në një takim me një grup gazetarësh të medieve vendase, pas takimeve me udhëheqësit e institucioneve dhe partive politike në Kosovë, Chollet ka pohuar se Shteti e Bashkuara presin nga Kosova t'i përmbushë të gjitha përkushtimet e saj në bisedimet me Serbinë, që përfshijnë edhe themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Asociacioni është një çështje urgjente në agjendën e dialogut. Ka

marrë një rëndësi edhe më të madhe pas ngjarjeve të fundit në veri", ka thënë Chollet.

Ai shtoi se ShBA-ja nuk mbështet diçka që i ngjan Republika Srpskës. "Dua të jem i qartë, ne nuk e mbështesim dhe nuk do ta mbështesim një organizimin të tipit Republika Srpska. Nuk po i kërkojmë Kosovës asnjë aranzhim që nuk është në pajtim me Kushtetutën dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2015. Parlamenti i Kosovës i ka ratifikuar marrëveshjet e Brukselit dhe Gjykata Kushtetuese ka thënë se është i domosdoshëm të themelohet Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe, e që besojmë se e bën këtë një detyrim ligjor për Qeverinë e Kosovës", ka deklaruar Chollet, duke nënvizuar se zhvillimet e fundit në veriun e Kosovës vetëm

sa e kanë theksuar rëndësinë e themelimit të tij.

Ai i cilësoi të rënda javët në prag të Krishtlindjeve në veriun e Kosovës ku për tre javë me radhë grupe serbësh mbajtën të bllokuara rrugët kryesore në shenjë proteste ndaj arrestimit të një ish-polici serb nën dyshimet për sulm ndaj autoriteteve. Rrugët u zhblokuan më 29 dhjetor pasi ish-polici u dërgua në arrest shtëpie. Ai ishte një nga qindra pjesëtarët e policisë nga radhët e komunitetit serb që braktisën vendet e punës sikurse edhe punonjësit e tjerë të këtij komuniteti në veriun e Kosovës mes mospajtimeve me vendimin e qeverisë në Prishtinë për ndalimin e përdorimit të targave të makinave të lëshuara nga Serbia. Chollet e cilësoi shqetësues boshllëkun në institucionet në veri, ndërsa nënvizoi se "duhet t'i japim fund këtij cikli të ngeçjes dhe është koha të vihemi në punë. Një nga mesazhet që sollëm këtu dhe do ta transmetojmë edhe në Beograd është se duam ta shpenzojmë energjinë diplomatike amerikane për të punuar për të ardhmen euro-atlantike për Kosovën. Duam të shpenzojmë më pak energji në menaxhimin e krizave. Së këndejmi, mesazhi ynë këtu dhe në Beograd është se nuk duhet të

ketë veprime provokuese, duhet ta shtensionojmë situatën dhe ta marrim situatën në duar".

Chollet ka theksuar se Kosova dhe Serbia duhet të përfshihen urgjentisht në bisedimet e lehtësuara dhe të drejtuara nga Bashkimi Evropian që do të çojnë drejt një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve me njohjen e ndërsjellë në qendër. Ai ka thënë se ky dialog është mënyra më e mirë për Kosovën që ta sigurojë ardhmërinë e saj evropiane dhe euroatlantike.

Zyrtari amerikan shtoi se marrëdhëniet e ShBA-së me Kosovën "mbeten shumë të forta" dhe se vizioni i tyre për vendin është "një Kosovë multietnike, e pavarur, sovranë, e sigurt dhe demokratike", duke shtuar se janë për integrimin e plotë të vendit në strukturat evropiane dhe euroatlantike. "Ashtu si ShBA-ja, edhe Kosova është një shoqëri e larmishme, multietnike dhe ne besojmë se diversiteti i bën vendet tona më të forta. Ne besojmë se Qeveria e Kosovës duhet ta festojë atë diversitet dhe duhet të vendosë politika që sjellin sukses për të gjithë kosovarët, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike". Chollet ka pohuar se duhet të

festohet për të gjitha ato që ka arritur Kosova ndër vite, por shtoi se do të "vijmë shumë sfida". "Ne nuk duam ta shohim duke u shpërdorur gjithçka që është arritur dhe nuk duam ta shohim atë potencial të madh, që mendoj se është real, i porealizuar", ka deklaruar ai.

Para takimit me gazetarë, Chollet takoi liderët institucionalë dhe të partive politike opozitare në Kosovë.

Chollet po qëndron në rajon në një periudhë përpjekjesh për ripërtëritjen e bisedimeve Kosovë-Serbi dhe nxitjes së proceseve integruese. Gjithashtu, po shtohen përpjekjet për një marrëveshje ndërmjet palëve në dritën e një propozimi evropian, që u bë i njohur si nisma franko-gjermane. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë takimit me Chollet ka falënderuar atë për angazhimin proaktiv të Shteteve të Bashkuara në procesin e dialogut, duke theksuar se angazhimi i shtuar amerikan në këtë drejtim është vendimtar për të siguruar rezultat të suksesshëm në dobi të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Osmani ka theksuar se marrëveshja përfundimtare, e cila duhet ta ketë në qendër njohjen e

Qeveria: Nuk përjashtojmë asnjë serb që të aplikojë në Policinë e Kosovës

PRISHTINË, 12 JANAR - Qeveria e Kosovës tha se nuk synon të përjashtojë asnjë serb që dëshiron të aplikojë në Policinë e Kosovës e që i plotëson kriteret e parapara. Në fillim të janarit Policia e Kosovës hapi konkurs për pranimin e zyrtarëve të rinj nga komunitetet joshumicë për t'i mbushur vendet bosh që janë në Drejtorinë Rajonale Mitrovicë - Veri.

Por, në konkurs një prej kriterëve është që kandidatët të mos jenë mbi 30 vjeç. "Thirrja është e hapur për të gjithë ata që përmbushin kriteret. Në parim ne nuk duam të

përjashtojmë askënd dhe ne nuk synojmë t'i zëvendësojmë serbët me shqiptarët sepse ne duam që serbët të përfaqësohen në institucionet tona multietnike", tha Qeveria e Kosovës në një përgjigje dërguar "Radios Evropa e Lirë". Autoritetet hapën konkursin pasi rreth 550 pjesëtarë të komunitetit serb u larguan nga Policia e Kosovës në katër komunat në veri të shtetit në nëntorin e vitit 2022.

Ata ishin në mesin e punëtorëve të sistemit të drejtësisë, institucioneve lokale dhe qendrore dhe të tjera, që u dorëhoqën në

shenjë pakënaqësie me një vendim të Qeverisë së Kosovës, që kërkonte nga serbët t'i reregjistrojnë makinat me targat e Kosovës dhe t'i largonin ato të lëshuara nga Serbia.

Qeveria tha se ky konkurs është mundësi e mirë për të gjithë ata persona që në të kaluarën nuk kanë mundur të punojnë në institucionet publike të Kosovës. Megjithatë, nga ekzekutivi nuk kanë treguar nëse ish-policët kanë të drejtë të aplikojnë në konkursin aktual. "Ne u bëjmë ftesë të gjithë serbëve që janë të interesuar dhe që i plotësojnë

kriteret, të aplikojnë për këto vende të hapura pune, veçanërisht ata që në të kaluarën nuk kanë pasur mundësi që të punojnë në sektorin publik për shkak të Listës Serbe e cila shpesh kushtëzonte punësimin me anëtarësim në këtë parti", tha qeveria.

REL-i e ka pyetur Policinë e Kosovës nëse ish-policët kanë të drejtë të aplikojnë, por nga ky institucion kanë thënë vetëm se kandidatët që i plotësojnë kriteret mund të aplikojnë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në fund të dhjetorit të

vitit të kaluar u bëri thirrje serbëve të aplikojnë për vende pune në institucionet e Kosovës, pasi argumentoi se "zbrazëtirën" që është krijuar në institucionet në veri nuk duan ta mbushin me shqiptarë.

Edhe misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX) u ka kërkuar serbëve të kthehen në institucionet e Kosovës, pasi ky mision tha se nuk mund ta mbushë vakuumin e krijuar nga dorëheqjet e policëve serbë në katër komunat në veri të Kosovës të banuar me shumicë serbe.



ndërsjellë, ka për qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe arritjen e paqes së qëndrueshme dhe afatgjatë në rajon. "Kosova është e gatshme të vazhdojë, me përkushtim të plotë, të jetë palë konstruktive, e koordinuar me ShBA-në, duke bërë propozime që kontribuojnë në arritjen e një marrëveshjeje të tillë", ka deklaruar Osmani.

Ndërkaq qeveria ka njoftuar se në takimin në mes të Kurtit dhe Chollet u diskutua për procesin e dialogut, planin evropian dhe për raportet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "U theksua nevoja për angazhim aktiv dhe konstruktiv në dialog dhe për shtim të përpjekjeve drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë me njohjen reciproke në qendër", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Këshilltari i DASH-it, në takimin me Osmanin dhe Kurtin, ishte i shoqëruar edhe nga i dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar.

Çfarë parasheh Asociacioni?

Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe parashikohet të mbledhë rreth vetes dhjetë komuna në Kosovë të banuara me shumicë serbe: Mitrovicë e Veriut, Kllokot, Partesh, Ranillug, Graçanicë, Zveçan, Zubin Potok, Novobërdë, Leposaviq dhe Shtërpçë. Sipas marrëveshjeve, Asociacioni ka për qëllim t'i përfaqësojë interesat kolektive të këtyre komunave, veçmas në fushën e arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural si dhe të ekonomisë.

Marrëveshja e vitit 2013 për Asociacionin thekson se ai do të krijohet me statut dhe strukturat e tij mbi bazën e statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Po ashtu, thuhet se Asociacioni do të ushtrojë edhe



përgjegjësi të tjera shtesë, varësisht se si delegohen nga autoritetet qendrore dhe që do të ketë një rol përfaqësimi tek autoritetet qendrore.

Sipas marrëveshjes të vitit 2015 për parimet për krijimin e Asociacionit, objektivat kryesorë të Asociacionit janë: ushtron vështrimin e plotë për zhvillimin

e ekonomisë lokale; ushtron vështrimin e plotë në fushën e arsimit; ushtron vështrimin e plotë për përmirësimin e shëndetësisë lokale primare e sekondare dhe përkujdesjen sociale; ushtron vështrimin e plotë për koordinimin e planifikimit urban dhe rural; aprovon masa për përmirësimin e kushteve lokale të jetesës për të kthyerit në Kosovë; zhvillon, koordinon, lehtëson aktivitete hulumtuese dhe zhvillimore; promovon, shpërndan, dhe avokon për çështjet me interes të përbashkët të anëtarëve të tij dhe i përfaqëson ata përfshirë tek autoritetet qendrore; vendos marrëdhënie dhe hyn në marrëveshje bashkëpunimi me asociacionet tjera të komunave, vendore dhe ndërkombëtare etj.

Policia sekuestron gjashtë armë zjarri

PRISHTINË, 12 JANAR - Policia e rajonit të Prishtinës, respektivisht hetuesit e stacioneve policore Jug, Veriu dhe Podujeva, gjatë kësaj jave kanë sekuestruar gjashtë armë

zjarri, të cilat personat e dyshuar i kanë përdorur dhe ekspozuar në rrjete sociale. Operacionet policore janë ndërmarrë në koordinim me prokurorin e shtetit ku, pas

identifikimit të lokacioneve dhe personave të dyshuar, kanë shoqëruar në polici personat të cilët kishin postuar në rrjete sociale fotografi me armë dhe video duke shtënë me armë

zjarri. Pas përfundimit të të gjitha procedurave të nevojshme policore ndaj personave të dyshuar janë iniciuar raste për posedim dhe përdorim të armës.



Kosova e ka obligim kushtetues kthimin e presidentit Thaçi në atdhe!

Shkruan: Sali BISLIMI

Gjykata Speciale devijon objektivin për të cilën është krijuar. Ajo sot ka humbur kredibilitetin për të qenë e Kosovës, duke qenë edhe politike e njëetnike.

Ajo inspiron ëndrrat e Serbisë për t'u kthyer në Kosovë.

Dënimi i Sali Mustafës është një fakt që serbët u trimëruan dhe kërkuan nga KFOR-i kthimin e ushtrisë serbe në Kosovë. Destabilizimi i veriut lidhet pikërisht me politikën e kësaj gjykate që është anti-Kosovë, e cila sulmon themelet e shtetit të Kosovës dhe vë në rrezik stabilitetin frazhill në rajon.

Kjo gjykatë do të vret definitivisht procesin demokratik dhe integrimin e vendit tonë në Bashkimin Evropian.

Si e tillë siç është sot duke devijuar objektivin për të cilin është krijuar, ajo duhet të stopohet që të mos t'i japim vetes një autogol.

Kosova jeton mes luftës dhe paqes. Perspektiva evropiane

është e kufizuar, e panjohur akoma nga 5 vendet e Bashkimit Evropian. Prezenca e Turqisë me islamizimin radikal nuk na ndihmon, ajo është bërë gangrenë për interesin vital të Kosovës. Kjo gjykatë e Kosovës pa asnjë gjyqtar të Kosovës është argumenti më i madh se ajo nuk duhet të ekzistoj.

Ky është një shkrim i vogël por me një rëndësi të madhe. I bëjë ftesë Parlamentit të Kosovës dhe Qeverisë që ta rishikojnë punën e kësaj gjykate e cila do të jetë vrastare për interesat strategjike të Kosovës dhe vetë ekzistencën tonë si shtet.

Nëse e doni Kosovën më shumë se pushtetin, atëherë veproni. Unë nuk njoh vend në botë që ka fituar lirinë pa dhimbje, vuajtje dhe viktima. Nuk e meritojmë të na përsëriten të këqijat, sepse edhe një lindje fëmije pa dhimbje dhe gjak nuk del në jetë. President nuk do të lejohet të fiton Tradhtia!

(Autori është 'Ambasador i Paqes' dhe drejtor i OJQ 'Zëri Perëndimor i Kosovës')



Osmani pranon letrat kredenciale nga ambasadori jorezident i Danimarkës

PRISHTINË, 12 JANAR - Presidentja Vjosa Osmani ka pranuar letrat kredenciale nga ambasadori jorezident i Danimarkës në Kosovë, Christian Gronbech-Jensen, të cilit i ka uruar mirëseardhje.

Osmani ka theksuar se marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve janë shumë të mira, ndaj në këtë kontekst shfaq besimin se ato do të shtohen edhe më tej gjatë mandatit të ambasadorit Christian Gronbech-Jensen.

Në takim me ambasadorin Gronbech-Jensen, presidentja Osmani ka folur edhe për zhvillimet aktuale politike dhe të



sigurisë në vend dhe ka theksuar se institucionet e vendit janë të

përkushtuar për paqe e stabilitet. Osmani ka thënë se Kosova ka

nevojë për mbështetjen e mëtejme nga Danimarka sa i

përket anëtarësimit në Këshillin e Evropës, por edhe në organizata të tjera ndërkombëtare.

Nga ana tjetër, ambasadori Gronbech-Jensen ka theksuar se Danimarka e mbështet anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës dhe në të njëjtën kohë e mirëpret aplikimin e Kosovës për anëtarësim në BE. Me ambasadorin Gronbech-Jensen, presidentja Osmani bisedoi edhe për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve në fushën e energjisë, shkëmbimit ekonomik e tregtar, arsimit, drejtësisë si dhe sferave të tjera të interesit të dyanshëm.

Shkarkohet drejtori i Kardiokirurgjisë, Rifat Brahimaj, u.d. emërohet Shpejtim Shurdhiqi

PRISHTINË, 12 JANAR - Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar

se pas analizës së situatës së fundit në Shërbimin Klinik të Kardiokirurgjisë, është liruar nga

detyra e ushtruesit të detyrës së drejtorit dr. Rifat Brahimaj. Ushtrues detyre i drejtorit të

Shërbimit të Kardiokirurgjisë në QKUK është caktuar dr. Shpejtim Shurdhiqi.



HRW: Një vit plot tensione, kërcënime dhe shkelje të të drejtave të njeriut

PRISHTINË, 12 JANAR - Tensionet e shkaktuara në veri të Kosovës, kërcënimet dhe frikësimet ndaj gazetarëve, vrasjet e grave nga bashkëshortët dhe diskriminimi i komunitetit LGBT+ në Kosovë, janë disa nga çështjet që organizata Human Rights Watch (HRW) përmendi në raportin për të drejtat e njeriut për vitin 2022 për Kosovë. Raporti u publikua më 12 janar.

Në raportin e 33-të HRW monitoroi gjendjen e të drejtave të njeriut gjatë vitit 2022 në 100 vende të botës, përfshirë Bosnjë dhe Hercegovinën (BeH), Kosovën dhe Serbinë. Gjendja e të drejtave të njeriut në Ballkanin Perëndimor, siç u tha nga kjo organizatë ndërkombëtare joqeveritare, ende karakterizohet nga ndjekja e ngadaltë e krimeve të luftës, qëndrimi i dobët ndaj të drejtave të minoriteteve, grave dhe komunitetit LGBT, si dhe liritë e dobëta të medias.

Te pjesa e Kosovës, në raport u trajtua edhe çështja e keqtrajtimit të gazetarëve në Kosovë, sulmet dhe kërcënimet ndaj tyre dhe, siç u tha, reagimi i dobët i organeve të shtetit.

Sipas raportit, në periudhën janar-gusht 2022 nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës janë regjistruar 22 raste të sulmeve, katër raste më shumë të regjistruara se në vitin 2021 për ngacmimet dhe kërcënime ndaj gazetarëve dhe organeve të medias.

HRW e citoi AGK-në të ketë thënë se hetimet penale për këto raste janë të ngadalshme. "Shoqata raportoi se në shumicën e rasteve gazetarët përballen me ngacmime, kërcënime dhe frikësim në platformat e medie sociale", u tha në raportin vjetor.

Ndër të tjera, u raportua edhe për gjuhën e përdorur ndaj gazetarëve nga ana e bashkëshortit të presidentes së Kosovës, Vjosa Osmanit, i cili njëherësh është edhe zyrtar i lartë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës të Kosovës, Prindon Sadriu, si dhe shefit të kabinetit të kryeministrit të Kosovës, Luan Dalipi.

Në shkurt Sadriu, me një postim në "Facebook", etiketoi gazetarët dhe mediet në Kosovë si "ndërmarrje e përbashkët kriminale".

Ndërsa në mars, shefi i kabinetit të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, Luan Dalipi, në një postim në "Facebook", lidhi mediet e Kosovës me "biznese kriminale" dhe u bëri thirrje qytetarëve që t'i bojkotojnë ato. "Deklarata të tilla rrezikojnë të minojnë besimin e publikut në medie dhe të krijojnë një mjedis armiqësor për gazetarët", tha HRW.

Raporti përmendi edhe 310 kthime të detyruara në Kosovë, shumica nga Gjermania, ku në mesin e tyre ishin 38 fëmijë, gjashtë romë, 13 ashkali dhe të tjerë shqiptarë etnikë.

Human Rights Watch u ndal edhe te dhuna ndaj gjinisë femërore në Kosovë, ku është përmendur rasti i dhunimit të 11-vjeçares në Prishtinë nga pesë të dyshuar dhe vrasja e grave nga bashkëshortët e tyre. "Të mbijetuarit e dhunës në familje vazhdojnë të përballen me pengesa për të marrë mbrojtje, duke përfshirë disa ndjekje penale dhe dështimin e gjyqtarëve për të lëshuar urdhra ndalimi kundër dhunuesve, si dhe ulje të dënimeve në rastet e vrasjeve të grave nga bashkëshortët e tyre, sipas



Rrjetit të Grave të Kosovës", u tha në raport.

HRW u ndal edhe tek orientimi seksual dhe identiteti gjinor, ku tregon se Qendra për Barazi dhe Liri e komunitetit homoseksual (LGBT+) në Kosovë ka regjistruar pesë raste të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj komunitetit, katër prej të cilave kanë të bëjnë me dhunë nga anëtarët e familjes ose partnerët ndaj personave transgjinorë.

Në raport nga rajoni është përfshirë edhe shkelja e të drejtave të njeriut në Serbi, ku është theksuar dhuna ndaj gazetarëve të pavarur si dhe zhvillimi i Paradës së Krenarisë të komunitetit LGBT+ serb nën mbrojtje të policisë.

HRW theksoi se ndërmjet janarit dhe gushtit në Serbi, Zyra e Prokurorit për Krime të Luftës nisi shtatë hetime të reja kundër të dyshuarve për krime

luftë. Deri në gusht, 16 raste kundër 39 të pandehurve ishin para gjykatave në Serbi.

Gazetarët që kritikojnë qeverinë serbe, sipas raportit, janë të ekspozuar ndaj kërcënimeve dhe sulmeve me një përgjigje joadekuate nga shteti. Midis janarit dhe gushtit, u tha në raport, janë regjistruar dy sulme fizike ndaj gazetarëve, tre sulme në pronën e gazetarëve dhe 26 raste të ngacmimeve dhe kërcënimeve, ku përfshiheshin kërcënime me bombë ndaj gazetarëve dhe shtëpive të medias.

Nga rajoni i Ballkanit Perëndimor, vendet si Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi nuk janë përfshirë në raportin vjetor të organizatës.

Në raport është folur edhe për pushtimin e Ukrainës nga Rusia teksa është thënë se Rusia ka bërë shkelje të rëndë të të

drejtave të njeriut.

"Pushtimi i plotë i Ukrainës i presidentit rus, Vladimir Putin, i cili ka shënjestruar civilët, infrastrukturën dhe rezultoi në mijëra viktima civile, tërhoqi vëmendjen e botës dhe shkaktoi arsenalin e plotë të sistemit të të drejtave të njeriut. Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut hapi një hetim për abuzime dhe caktoi një ekspert për t'i monitoruar të drejtat e njeriut brenda Ruisë". "Viti i kaluar tregoi se të gjitha qeveritë mbajnë përgjegjësi për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në mbarë botën", tha Tirana Hassan, ushtruese detyre e drejtorit të HRW, pas publikimit të raportit. Sipas saj, nën sfondin e ndryshimit të pushtetit ka më shumë hapësirë për shtetet që të ngrihen për të drejtat e njeriut "teksa shfaqen koalicione dhe zëra të rinj të lidhshpirt". /REL/

Krasniqi: Raporti i HRW-së, tregues që Kurti abuzoi me të drejtat elementare të qytetarëve

PRISHTINË, 12 JANAR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka reaguar pas publikimit të raportit Human Rights Watch për Kosovën. Në raport përmenden vrasjet e grave, kërcënimet ndaj gazetarëve si dhe diskriminimi ndaj komuniteteve të marginalizuara.

Krasniqi ka theksuar se dhuna dhe vrasjet e grave, kërcënimet e gazetarëve nga zyrtarë institucionalë e diskriminimi i të gjitha komuniteteve të marginalizuara, dëshmojnë paaftësinë e kësaj qeverie. "Kaosin, mungesën e kompetencës, keqqeverisjen dhe pasigurinë sociale e

politike të krijuar gjatë vitit 2022 në vendin tonë, e ka evidentuar edhe raporti i fundit për Kosovën i organizatës Human Rights Watch. Dhuna dhe vrasjet e grave, kërcënimet e gazetarëve nga zyrtarë institucionalë e diskriminimi i të gjitha komuniteteve të marginalizuara, dëshmojnë detajisht paaftësinë e kësaj qeverie. Shpërfaqja e mungesës elementare të përgjegjësive institucionale në vitin e kaluar, është tregues i qartë se çfarë i pret qytetarët e Kosovës edhe këtë vit nga kjo qeveri: Abuzim me të drejtat e tyre elementare!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".



Forumi Ekonomik Botëror: Dëmi mjedisor, inflacioni, siguria kibernetike, rreziqet për Kosovën

PRISHTINË, 12 JANAR - Dëmi mjedisor i shkaktuar nga njeriu, inflacioni i shpejtë, kostot e larta të jetesës, konfrontimi gjeo-ekonomik, dështimi i masave të sigurisë kibernetike dhe pabarazia digjitale janë rreziqet kryesore me të cilat mund të përballet Kosova gjatë dekadës së ardhshme, thuhet në Raportin për Rreziqet Globale 2023, të Forumit Ekonomik Botëror, që u publikua më 11 janar.

Sipas këtij raporti, kostoja e lartë e jetesës është renditur si rreziku më i rëndë botëror për dy vjetët e ardhshme. Aty nënvizohet se kriza ekonomike do të ndajë thellësisht vendet e pasura dhe ato të varfra, gjë që mund ta kthejë mbrapa zhvillimin dhe përparimin njerëzor.

Sa iu përket vendeve të rajonit, raporti thotë se Shqipëria rrezikohet më së shumti nga sëmundjet infektive, dështimi i masave të sigurisë kibernetike, inflacioni i shpejtë, kontestimi gjeopolitik i burimeve dhe kriza të rënda të furnizimit me mallra, kurse Serbia rrezikohet nga konfrontimi



gjeoekonomik, goditje të rënda të çmimeve të mallrave, konflikte ndërshtetërore, kriza të koston të jetesës dhe kriza të rënda të furnizimit me mallra. Maqedonia e Veriut, në anën tjetër, mund të përballet me krizë në kosto të jetesës, kriza të borxhit, dëm mjedisor të

shkaktuar nga njeriu, inflacioni i shpejtë dhe i qëndrueshëm dhe ngecje në rritje ekonomike. Edhe Mali i Zi, thotë raporti, mund të përballet me krizën e koston të jetesës, konfrontim gjeoekonomik, stagnim të rritjes ekonomike, dështim në përshtatje ndaj ndryshimeve

klimatike, dëm mjedisor të shkaktuar nga njeriu, kriza të rënda të furnizimit me mallra, kriza të borxhit, si dhe kriza në punësim dhe jetesë. Pasojat ekonomike të Covid-19 dhe luftës në Ukrainë kanë rezultuar në inflacion të lartë dhe ndryshime në politikat

monetare, duke shënuar rritje të ulët ekonomike dhe të investimeve në rang global.

“Rikthimi në ‘jetë normale’ pas pandemisë së Covid-19 u ndërpre shpejt nga shpërthimi i luftës në Ukrainë, duke sjellë kriza të reja, veçanërisht në ushqim dhe energji”, shkruan raporti.

Raporti vë në dukje se dekada e ardhshme do të karakterizohet nga krizat mjedisore dhe shoqërore, të nxitura nga tendencat gjeopolitike dhe ekonomike.

Gjithashtu, humbja e biodiversitetit dhe kolapsi i ekosistemit janë përkeqësime më të shpejta globale gjatë dekadës së ardhshme.

“Pothuajse 3.6 miliardë njerëz në mbarë botën janë të ekspozuar në mënyrë të rrezikshme dhe të pambrojtur ndaj ndikimeve klimatike. Vendet në zhvillim, pavarësisht prej kontributit të tyre të kufizuar në ndryshimet klimatike, po mbajnë mbi supë barrën, por asnjë vend dhe asnjë ekonomi nuk është imune nga kriza klimatike”, thotë raporti.

Evropianëve u bie standardi i jetesës

BRUKSEL, 12 JANAR - Kriza e koston të jetesës, e shkaktuar nga lufta në Ukrainë, kriza e energjisë, rritja e inflacionit dhe pandemia e koronavirusit kanë shqetësuar qytetarët e Bashkimit Evropian, sipas një sondazhi të ri që tregon se 45 për qind e të anketuarve aktualisht kanë “disa” ose “shumë” vështirësi me të ardhurat e tyre personale.

46 për qind e evropianëve pranojnë se standardet e tyre të jetesës tashmë janë ulur si rezultat i krizave në rritje, ndërsa 39 për qind presin të shohin një rënie gjatë këtij viti. Vetëm 14 për qind prej tyre nuk parashikojnë asnjë lloj ndryshimi apo ndikimi në financa. Vendet ku rënia e perceptuar e standardit të



jetesës ka qenë më e theksuar janë Qiproja, Greqia, Malta, Franca dhe Portugali. Njerëzit në vendet nordike janë më të kënaqur me të

ardhurat e tyre aktuale. Por më shqetësues është fakti se 39 për qind e të anketuarve pranojnë se kanë vështirësi t'i paguajnë faturat e tyre mujore.

Greqia dhe Bullgaria raportojnë pjesën më të madhe të popullsisë që kalon këtë lloj vështirësie, me përkatësisht 86 për qind dhe

64 për qind. Në përgjithësi, 56 për qind e evropianëve shprehin pakënaqësi me masat e marra në nivel të BE-së për t'i trajtuar kostot në rritje të jetesës, ndërsa 64 për qind mendojnë të njëjtën gjë për veprimet e qeverive të tyre kombëtare.

Në total, 93 për qind e pjesëmarrësve në sondazh thonë se janë të shqetësuar për krizën e koston të jetesës, duke përfshirë rritjen e çmimeve të ushqimit dhe energjisë.

Ky sondazh i publikuar nga Parlamenti Evropian të enjten në mëngjes, bazohet në më shumë se 26 000 intervista ballë për ballë të kryera midis tetorit dhe nëntorit në të 27 vendet anëtare.

Rizvanolli bashkëbisedon me nxënësit e shkollës “Abdyl Frashëri” për mënyrat e kursimit të energjisë

PRIZREN, 12 JANAR - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, së bashku me përfaqësuesen e përhershme të UNDP-së në Kosovë, Maria Suokko, kanë vizituar shkollën “Abdyl Frashëri” në Prizren në kuadër të fushatës “Kurse energjinë”, për të bashkëbiseduar me nxënësit për rëndësinë e mënyrat më të mira për ta kursyer energjinë.

Gjatë bashkëbisedimit, ministria Rizvanolli u ka

treguar nxënësve për rëndësinë e kursimit të energjisë dhe kanë bashkëbiseduar mbi mënyrat se si nxënësit kursejnë energjinë, e çfarë veprime marrin për ta mbrojtur ambientin.

Ministren Rizvanolli dhe drejtoreshën Suokko në takim i kanë shoqëruar nxënës nga shkolla shembull “Faik Konica” në Prishtinë, të cilët për dy vjet me radhë, me vetiniciativë,

kanë zhvilluar fushatën e tyre për kursim të energjisë. Ata kanë paraqitur para bashkëmohatarëve të tyre se çfarë kanë ndërmarrë për kursim të energjisë në shkollën e tyre.

Nxënësit, së bashku me përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe UNDP-së, kanë zhvilluar një numër të lojërave dhe aktiviteteve për kursim e eficiencë të energjisë me qëllim të vetëdijesimit.



Pse rihapja e Kinës do të godasë fort ekonominë botërore



“The Economist”


Për pjesën më të madhe të 3 viteve të fundit – 1016 ditë për të qenë të saktë – Kina ishte e mbyllur ndaj botës. Shumica e studentëve të huaj u larguan nga vendi që në fillim të pandemisë së Covid-19. Turistët i pezulluan vizitat e tyre në këtë vend. Edhe shkencëtarët kinezë pezulluan pjesëmarrjen e tyre në konferencat e huaja. Drejtuesit jo kinezë u ndaluan të riktheheshin në bizneset e tyre që kishin në Kinë. Prandaj, kur vendi të rihapë kufijtë e tij më 8 janar, duke braktisur edhe masat e fundit të politikës së tij drakoniane “Zero Covid”, ripërtëritja e kontakteve tregtare, intelektuale dhe kulturore do të ketë pasoja të mëdha, kryesisht pozitive. Por së pari, do të ketë jo pak sfida të vështira. Brenda Kinës, virusi po përhapet me njëshpejtësi të jashtëzakonshme. Dhjetëra miliona njerëz po preken çdo ditë prej tij. Spitalet janë të mbingarkuara me të sëmurë. Ndonëse politika e “Zero Covid”, shpëtoi shumë jetënjerëzish kur u prezantua në fillim (edhe pse me kosto shumë të madhe për liritë individuale), qeveria dështoi të përgatitej siç duhet për fazën e lehtësimit të masave, nëpërmjet grumbullimit të barnave, vaksinimit të më shumë të moshuarve dhe miratimit të protokolleve të forta për të vendosur se cilët pacientë do të trajtonin. Modeli ynë sugjeron që nëse virusi përhapet në mënyrë të pakontrolluar, rreth 1.5 milionë kinezë do të vdesin gjatë muajve të ardhshëm. Dhe në këtë situatë të

huajt nuk kanë se çfarëtë bëjnë. Nga frika se mos duket e dobët, qeveria kineze refuzon edhe ofertat nga Evropa përvaksinat anti-Covid falas, të cilat janë më efektive. Por pjesa tjetër e botës mund të përgatitet për efektet ekonomike të kthesës së madhe të Partisë Komuniste. Këto efekte nuk do të jenë shumë të buta. Ekonomia e Kinës mund të bjerë në 3-mujorin e parë të këtij viti, sidomos nëse zyrtarët lokalë ndryshojnë kursin duke mbyllur sërish qytetet e tyre për të ulur numrin e rasteve. Por përfundimisht aktiviteti ekonomik do të rimëkëmbet ndjeshëm, së bashku me kërkesën kineze për mallra dhe shërbime. Ndikimi do të ndihet në plazhet e Tajlandës, tek kompani të tilla si Apple dhe Tesla, por edhe tek bankat qendrore të botës. Rihapja e Kinës, do të jetë ngjarja më e madhe ekonomike e këtij viti. Me kalimin e kohës dhe me kalimin e valës më të rëndë të Covid-it, shumë prej të sëmurëve do të rikthehen në punë. Blerësit dhe udhëtarët do të shpenzojnë më lirshëm. Disa ekonomistë mendojnë se Prodhimi i Brendshëm Bruto në 3 muajve parë të vitit 2024, mund të jetë 10 për qind më e lartë sesa në 3-mujorin e parë të trazuar të vitit 2023. Një rikthim kaq i fortë në një ekonomi kaq të madhe, do të thotë se Kina e vetme mund të fuqizojë pjesën më të madhe të rritjes globale gjatë kësaj periudhe. Partia Komuniste ka varur të gjithë shpresat e saj tek kjo gjë. Ajo shpreson të gjykohej jo nga tragjedia që po shkakton paaftësia e saj, por nga rimëkëmbja ekonomike që do të pasojë. Në fjalimin e fundvitit të Xi Jinping,

lideri i partisë falënderoi punonjësit e vijës së parë të luftës kundër pandemisë, të cilët qëndruan me guxim në vendet e tyre të punës. Ai pranoi “sfidat e vështira që ndodhen përpara”, dhe premtoi se “drita e shpresës është pikërisht para nesh”. Ai dukej i etur për të parë përtej pandemisë, duke theksuar shanset e një ringjalljeje të shpejtë ekonomike këtë vit, dhe duke u ofruar kinezëve arsye për të qenë krenarë që jetojnë në një Kinë në rritje të vazhdueshme nën sundimin e PKK. Dhënia fund e izolimit të vetë-imponuar të Kinës, do të jetë një lajm i mirë për vendet që vareshin nga shpenzimet e Kinës. Hotelet në Phuket dhe qendrat tregtare në Hong Kong, vuajtën shumë pasi kinezët u mbyllën në shtëpi. Tani udhëtarët e mundshëm kanë nisur kërkimet në faqet e agjencive turistike. Rezervimet në Trip.com u rritën me 250 për qind më 27 dhjetor, krahasuar me një ditë më parë. Me kalimin e kohës, ekonomistët parashikojnë një rritje të PBB-së për Hong Kongun deri në 8 për qind. Nga kjo do të përfitojnë edhe eksportuesit e mallrave që konsumon Kina. Vendi ble 1/5 e naftës botërore, mbi gjysmën e bakrit, nikelit dhe zinkut të rafinuar dhe më shumë se 3/5 e mineralit të hekurit. Megjithatë diku tjetër, rimëkëmbja e Kinës do të ketë efekte anësore të dhimbshme. Në pjesën më të madhe të botës, ajo mund të shfaqet jo në një rritje ekonomike më të lartë, por me një inflacion apo norma interesi më të larta. Bankat qendrore po i rrisin tashmë normat me shumë nxitim për të

luftuar inflacionin. Nëse rihapja e Kinës e shton presionin e çmimeve në një shkallë të madhe, ata duhet të mbajnë për një kohë më të gjatë politika monetare më të shtrenguara. Vendet që importojnë mallra, përfshirë pjesën më të madhe të Perëndimit, janë më të rrezikuara nga një ndërprerjeje e tillë. Shihni tregun e naftës. Rritja e kërkesës kineze do të kompensojë konsumin e lëkundur në Evropë dhe Amerikë, pasi ekonomitë e tyre po ngadalësohen. Sipas bankës Goldman Sachs, një rimëkëmbje e shpejtë në Kinë mund të ndihmojë në rritjen e çmimit të naftës së papërpunuar në 100 dollarë për fuçi, një rritje me 25 për qind krahasuar me çmimet e sotme (ndonëse në kulmin e arritur në javët e para kur Rusia pushtoi Ukrainën). Rritja e kostove të energjisë, do të jetë një pengesë tjetër për uljen e inflacionit. Për Evropën, rihapja e Kinës është një arsye tjetër për të mos qenë të vetëkënaqur me furnizimet me gaz më vonë gjatë vitit. Duke e reduktuar kërkesën e Kinës për gaz, qasja “Zero Covid”, e bëri atë më pak të kushtueshme sesa do të kishte qenë për Evropën që po mbushte depozitat saj gjatë vitit 2022. Një rimëkëmbje e fortë e ekonomisë në Kinë, do të nënkuptonte më shumë konkurrencë për importet e gazit natyror të lëngshëm. Në dhjetor 2022, Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë, paralajmëroi një skenar në të cilin dimri nis saktësisht në fillim të këtij viti, dhe kur Rusia endërpret plotësisht eksportet e gazin në Evropës përmes tubacioneve.

Kjo mund të shkaktojë në mungesa që arrijnë deri në 7 për qind të konsumit vjetor të kontinentit, duke e detyruar atë të vendosë racionimin. Për vetë Kinën, normaliteti pas pandemisë nuk do të jetë një kthim tek statusquo-ja e vjetër. Pasi e panë qeverinë që të zbatonte politikën e ashpër “Zero Covid”, dhe më pas ta heqë atë pa parapërgatitjen e duhur, shumë kompani investimi e shohin tani Kinën si një bast më të rrezikshëm. Kompanitë e huaja janë më pak të sigurta se operacionet e tyre nuk do të ndërpriten. Shumë prej tyre janë të gatshëm të paguajnë kosto më të larta për të prodhuar diku tjetër. Investimet mbi fabrikat e reja duket se po ngadalësohen, ndërsa sipas disa të dhënave është rritur numri i kompanive që po e zhvendosin biznesin jashtë Kinës. Ndërsa zyrtarët kinezë po përpiqen të riparojnë dëmet, ata duhet të kujtojnë disa histori. Rihapja e mëparshme e madhe e Kinës, pas izolimit mbyttës të viteve të Maos, çoi në një lulëzim të madh ekonomik pasi mallrat, njerëzit, investimet dhe idetë u zgjeruar përtej kufijve të saj në të dy drejtimet. Si Kina ashtu edhe bota kanë përfituar nga flukse të tilla, diçka që politikanët në Pekin dhe Washington e pranojnë shumë rrallë. Nëse kemi fat, rihapja aktuale e Kinës mund të rezultojë të jetë një sukses. Por do të mbetet sërish një pjesë e ndjenjës paranojake, ksenofobike që ngjalli Partia Komuniste Kineze gjatë viteve të pandemisë. Se sa e hapur do të jetë saktësisht Kina e re, kjo mbetet për t'u parë.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

E lashë shkollën për futbollin

MALLORCA, 12 JANAR - Gazeta spanjolle "Marca" e nisi shkrimin duke treguar se nuk ka kaluar as një vit që kur Vedat Muriqi, i lindur më 24.04.1994 në Prizren, zbarkoi në ishull për të nënshkruar për Mallorcan. Ishte afati dimëror për sezonin 2021/22 dhe skuadrës spanjolle i duhej një sulmues për të luftuar për qëndrueshmërinë në La Liga. Ardhja e yllit nga Kosova i befaso i tifozët e Mallorcas: ai nuk po luante me Lazio dhe numrat e tij nuk ishin më tërheqës. Por, me 33 ndeshje dhe 14 gola më vonë, Muriqi tashmë është rikthyer si idhull në Mallorca. "Il Pirata" apo "Pirati", i cili e përjetoj luftën ballkanike si fëmijë, ka marrë pjesë në një intervistë të gjatë me gazetën "Marca"-n për të bërë të qartë se qëndrimi i tij në ishull do të jetë afatgjatë.

"Marca": Rikthimi në garë pas pushimit duket se ka ndikuar veçanërisht në Mallorca?

Muriqi: Ne ishim skuadra e fundit që donim pushim në atë kohë. Në katër ndeshje shumë të vështira morëm dhjetë pikë dhe kishim shumë besim dhe dëshirë. Pas pushimit është më e vështirë sepse duhet të rifitosh besimin nga ndeshjet, por edhe në nivel fizik dhe mendor. Fitorja ndaj Valladolidit na ka dhënë shumë besim. Nuk doja një pushim në mes të sezonit, ishte mirë si më parë, luajtëm të gjithë sezonin dhe më pas u mbajt Kupa e Botës në verë. Shpresojmë të fillojmë të jemi si para pushimit.

"Marca": Është folur shumë për largimin e mundshëm në merkaton e janarit. Është një opsion që përjashtohet apo mund të ndodhë?

Muriqi: Nuk kam menduar kurrë të largohem. As në janar, 100 për qind jo. Por është diçka që nuk është në dorën time sepse ndonjëherë vjen një skuadër që mund të pajtohet me Mallorcan, më thonë 'të shesim' dhe nuk mund të them asgjë. Kam një kontratë shumëvjeçare me Mallorca dhe nuk dua të largohem kurrë. Jam i lumtur këtu, edhe familja ime, po luaj dhe po kaloj mirë, mendoj dhe prandaj nuk kam menduar kurrë të largohem.

"Marca": Ju thatë pas një ndeshje që Pablo Ortells nuk ka rëndësi, se nëse një klub vjen për të paguar

klauzolën e largimit, ata nuk do të duan të largojnë. Mendoni akoma të njëjtën gjë?

Muriqi: Unë ende mendoj të njëjtën gjë. Nëse Pablo Ortells vjen tek unë, do të përpiqem t'i them se nuk do të largohem, por këto janë gjëra që nuk janë në dorën time. Nëse duhet të vendos vetë, është e qartë që do të qëndroj këtu.

"Marca": Nëse do të varet nga ju, do të pensionoheshit në Mallorca?

Muriqi: Po, sepse mua personalisht më pëlqen shumë ky mot. Jemi në janar dhe ka diell. Familja ime është rehat, fëmijët shkojnë shumë mirë në shkollë... Ndonjëherë kur ke familje dhe fëmijë duhet të mendosh më shumë për ta sesa për veten, dhe këtë po bëj tani. Edhe për mua, sepse jam mirë që pas Fenerbahçes, kur shkova në Lazio, kam pasur një përvojë të keqe dhe nuk dua të dështoj më.

"Marca": Dyshja Muriqi-Kang In ka shënuar më shumë se 50 për qind të golave të skuadrës dhe, po ashtu, flitet se ai mund të largohet në janar...


Muriqi: Nuk e lë të shkojë (qesh). Kang In do të jetë me mua këtu në Mallorca. Janë gjëra të klubit, por kjo nuk është puna jonë. Ne stërvitemi çdo ditë dhe do të vazhdojmë kështu.

"Marca": Keni përmendur të gjithë periudhën tuaj te Fenerbahçe dhe Lazio. Në planin mendor dhe psikologjik, si arritët që nga mosluajtja fare në Itali të jeni pjesë themelore në Mallorca?

Muriqi: E kam thënë gjithmonë se kam një mentalitet shumë të fortë. Kam kaluar dy muaj te Lazio që ishte shumë keq në të gjitha aspektet dhe gruaja ime më ndihmoi shumë për këtë, ajo ishte gjithmonë me mua. Kur erdha këtu pasi nuk luajta në Itali, e prisja me padurim. E dija që mund të ishin katër muajt e fundit në një nivel të lartë. Kjo është arsyeja pse unë doja t'i bëja gjërat siç duhet. Këtu që nga dita e parë më dhanë shumë besim. Edhe tifozët, prandaj doja t'ia ktheja.

"Marca": Pas mbërritjes në ishull edhe fansat iu dorëzuan figurës tuaj, duke ju quajtur 'pirat'.

Muriqi: Janë njerëz shumë të qetë që nëse nuk luan mirë apo kur



humbet, sërish të mbështesin. Më kujtohet dita kur humbëm 2-6 kundër Granadës. Atë ditë, po të pyesje dikë nga skuadra, të gjithë do të të thoshin se ishim tashmë në Kategorinë e Dytë. Por tifozët kishin besim dhe besuan tek ne. Në rastin tim, kur bën mirë, shënon gola dhe lufton, është normale që ata të të duan. Një mijë falënderime për ta sepse më japin shumë besim dhe ja ku jam në shtëpi.

"Marca": A ju pëlqen si luan Mallorca? Ndonjëherë ata janë kritikuar se janë tepër konservatorë, por realiteti është se kjo Mallorca është e pesta më e mira e shekullit të 21-të.

Muriqi: Unë jam sulmues dhe dua të shënoj gola. Është e vërtetë që luajtëm pak në mbrojtje, por në fund të sezonit askush nuk pyet se si keni luajtur, ata shikojnë vetëm tabelën dhe shohin nëse jeni në Kategorinë e Parë apo jo. Nuk do të doja të luaja kundër Mallorcas, sepse jemi një ekip shumë i etur. Ndonjëherë duket se nuk do të bëjmë asgjë, por vjedhim një top, bëjmë 1-0 dhe shkojmë në shtëpi me fitore.

"Marca": Duke folur për lojën e skuadrës, si e vlerësoni figurën e Javier Aguirre?

Muriqi: Që në ditën e parë që ka ardhur ka qenë shumë i sjellshëm me të gjithë. Kur ai erdhi ne kishim 12 ndeshje pa fituar, ishim në një

moment shumë të vështirë dhe mbi të gjitha ai u fokusua në mos shënimin e golave. Kjo na dha shumë besim. Tani, këtë sezon, skuadra ka ndryshuar, por nuk do të thosha 100 për qind. Ai ka përfshirë gjithë përvojën e tij, është shumë i disiplinuar dhe kjo më pëlqen shumë.

"Marca": Ka shumë lojtarë që kalojnë në Mallorca dhe kur të dalin në pension qëndrojnë në ishull, a planifikoni të investoni këtu?

Muriqi: Kam tetë vjet që jetoj në Turqi dhe gjithmonë kam dashur të jetoj atje. Madje kam bërë gjëra për të qenë atje, por kur mbërrita në Majorca... Kam gati një vit në ishull dhe e vërteta është se më ka ndryshuar shumë. Tashmë jam duke kërkuar një shtëpi për të jetuar.

"Marca": Në vitet '90 shpërtheu lufta ballkanike dhe ju ishit fëmijë, si e kujtoni atë kohë?

Muriqi: Unë gjithmonë them që asnjë qenie njerëzore nuk duhet të shohë gjërat që kam parë unë gjatë atyre viteve. Duhet të arratisesh nga shtëpia, erdhën disa ushtarë, dhe thanë se do të vendosin bomba dhe ti duhej të ikje. Shkuam në Shqipëri dhe ishte një kohë shumë e vështirë. Nëse shikoj pjesën pozitive, të jetosh që tani më bën të vlerësoj gjërat e vogla shumë më tepër.

"Marca": Ju punonit që në moshë shumë të re, si ishte kalimi juaj nga fëmijë në të rritur?

Muriqi: Fillova të punoja në një restorant në pronësi të xhaxhallarëve të mi kur isha nëntë vjeç. Aty bëja gjithçka: kamerier, ndihmës në kuzhinë etj. E gjithë kjo derisa mbërrita në Shqipëri në moshën 16-vjeçare. Gjatë asaj kohe, vetëm unë mund të punoja për të mbajtur nënën dhe motrën time, pasi babai im vdiq në luftë. Edhe unë kisha shkollë edhe futboll; dhe kjo është arsyeja pse vendosa të lë shkollën, sepse nuk mund ta lija futbollin, është jeta ime. E di që nuk kam bërë mirë duke e lënë shkollën dhe tani mund të them se kam qenë shumë me fat.

"Marca": Si i duket futbollin një fëmijë që po përjeton një luftë drejtpërdrejtë?

Muriqi: Pas luftës, ekipi nga qyteti im njoftoi se do të merrnin fëmijët të luanin dhe të stërviteshin. Nëna ime, e cila e pëlqen shumë futbollin, më shtyu të shkoja në stërvitje edhe pse ishte shumë larg shtëpisë sonë. Asnjëherë në jetën time nuk kam menduar se mund të bëhesha një lojtar profesionist. As nuk e imagjinoja të shkoja në Turqi, të shënoja gola, të shkoja në Serie A... Nuk mund ta imagjinoja kurrë sepse ishte shumë e vështirë të dilje prej andej. Në fund ia dola falë mentalitetit, punës dhe fatit tim.

Ferizaj paraqet Jovanovskin

FERIZAJ, 12 JANAR - FC Ferizaj ka njoftuar se ka arritur marrëveshje me portierin e njohur dhe me përvojë nga Maqedonia e Veriut, Marko Jovanovski. Së fundmi, Jovanovski ishte pjesë e

nënkampionit të Maqedonisë, Akademija Pandev, ku për dy sezone ishte titullar i padiskutueshëm. "Për mua është kënaqësi që do të jem pjesë e Klubit të Ferizajt.

Para se të vija kam dëgjuar shumë fjalë të mira për organizimin e klubit dhe se padyshim me njerëz profesionistë e me motiv për punë, ne do të arrijmë objektivat tona. Ju premtoj

që në secilën ndeshje do të jap 100 për qind nga vetja ime", është shprehur Marko Jovanovski. Ditët në vazhdim FC Ferizaj do t'i paraqesë edhe ardhjet e reja në klub.



Verstappeni: Do të jetë e vështirë për titull, Ferrari dhe Mercedesi do të jenë pranë nesh

AMSTERDAM, 12 JANAR - Askush nuk e mendonte se vjet, Ferrari do t'i thoshte lamtumirë garës për titull që në fund të gushtit, pas atij starti fantastik që i bëri sezonit. Rikuperimi i jashtëzakonshëm që Red Bull i bëri "kokëkuqes" vuri me shpatulla pas muri makinën

italiane. Gjithsesi, Max Verstappen, që u shpall kampion bote, beson se këtë vit s'do të jetë kaq e lehtë sa vjet. "Në fakt, prisja që Ferrari vjet të duelonte për titull deri në fund. Nuk kanë qenë të shumta garat që ne kishim diferenca të mëdha, pasi shpesh duelonim

fort. Gjithsesi, jam i kënaqur që vjet e fitova titullin disi më lehtë se në vitin 2021, kur dueluam deri në xhiron e fundit me Lewis", u shpreh Max Verstappen. Gjithsesi, piloti holandez është i bindur se këtë sezon do të vuajë sërish më shumë: "Këtë vit do të jemi

shumë pranë njëri-tjetrit, Ferrari e Red Bull. Madje edhe Mercedesi do të na rivalizojë. Do të jetë një përballje e fortë, ku do të vendosin detajet. Askush nuk do të përsëritë më të njëjtat gabime si vjet, ndaj do të shohim spektakël në pistë".



Zbulohet kriteri që nuk po arrin të plotësohet për ta sjellë stadiumin '974' në Kosovë

PRISHTINË, 12 JANAR - Stadiumi "974", arenë në të cilën u zhvilluan disa prej ndeshjeve në Kampionatin Botëror të futbollit, u përfol se mund të bartet në Kosovë për shkak të strukturës së tij të ndërtimit prej 974 kontejnerëve. Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, kishte thënë për "KosovaPress" se Kosova ka kandiduar për ta marr atë stadium, sidomos pas vizitës së Gianni Infantinos në Kosovë, por një gjë e tillë duket vështirë e realizueshme dhe është Ademi ai që ka thënë se kostoja tejet e lartë e bartjes së tij nga Katar në Kosovë është pengesa kryesore. Por, përkundër kësaj, i pari i FFK-së thotë se Kosova është ende në garë sepse edhe më tutje nuk është vendosur se kujt do t'i jepet ai stadium. "Jemi ende në garë sepse nuk i është dhënë askujt. Jemi konkurrent potencial, por ne nuk e kemi plotësuar një kriter. Kriteri është që nuk kemi dërguar pjesë garantuese,



apo letër garantuese që transportin do ta bëjmë, sepse është kriter, është kusht. Ne si federatë nuk kemi mundur, sepse aq sa kushton, me njohuritë që janë dhënë përafërsisht, nuk e kemi buxhetin, përafërsisht aty është buxheti i Federatës së Futbollit dhe nëse ne e dërgojmë një garancion me buxhetin tonë, do të thotë do të ishte e paarsyeshme për vetë faktin se nëse ti e harxhon të gjithë

buxhetin në transport, atëherë si do të veprojmë si federatë", ka thënë Ademi. "Është shumë dhe tani presim, pavarësisht kësaj, të gjejmë mirëkuptim dhe nëse na dhurojnë atë stadium, do të jetë mundësia ndoshta me sponsor, pak ne, pak shteti dhe dikush, që të mundohemi që ta sjellim atë stadium këtu, që do të ishte mrekullia vetë", ka shtuar Ademi për "KosovaPress".

Denveri, Memphisi e Bostoni fitojnë dhe konsolidojnë pozitat në krye

Denver, 12 dhjetor - Denveri dhe Memphisi vijnë të jenë krah për krah në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit. Nuggetsi fitoi me rezultat 126-97 ndaj Phoenixit, sfidë ku shtatë lojtarë të Denverit realizuan mbi 10 pikë (Hyland e Jokiq nga 21 pikë secili). Ndërsa Memphisi, falë 38 pikëve të Ja Morantit, mundi me rezultat 135-129 San Antonion. Në Lindje, në krye të renditjes, ndodhet ekipi i Bostonit, që mposhti me rezultat 125-114 New Orleansin. Jaylen Brown me 41 pikë



ishte shënuesi më i mirë për Celticsin, duke i bërë të pavlefshme 38 pikët e McCollum për miqtë. Nuk zhgënjën Milwaukee, që mundi me rezultat 114-105 Atlantën jashtë fushës, sfidë ku diferencën e bëri Jrue Holiday me 27 pikë. Zhgënjën Chicago, që u mund me rezultat 100-97 nga Washingtoni, ndeshje ku për

vendasit u dallua Kuzma me 21 pikë, ndërsa Detroiti triumfoi me rezultat 135-118 ndaj Minnesotas, me Saddiq Bey protagonist, autor i 31 pikëve. New Yorku mundi me shifrat 119-113 Indianan (Brunson 34 pikë), ndërsa Sacramento mposhti me rezultat 135-115 Houstonin (Sabonis 25 pikë e 14 rebounde).

REZULTATET

Detroit - Minnesota	135-118
Washington - Chicago	100-97
Atlanta - Milwaukee	105-114
Boston - New Orleans	125-114
New York - Indiana	119-113
Memphis - San Antonio	135-129
Denver - Phoenix	126-97
Sacramento - Houston	135-115

Moura do të largohet nga Tottenhami

Lucas Moura do të largohet nga Tottenham Hotspuri në fundin e sezonit pasi klubi londinez vendosi të mos i ofrojë rinovim të kontratës.

Anëtori nuk dëshiron të largohet në afatin e janarit pasi në verë do të jetë agjent i lirë, diçka nga e cila mund të përfitojë për një pagë më të

lartë si dhe një projekt më të mirë. 30-vjeçari iu bashkua "Spurs"-in në janarin e vitit 2018 dhe do të largohet pas më shumë se pesë vjetëve

shërbim. Anëtori i Sao Paulo ka bërë 213 paraqitje për Tottenhamin duke shënuar 38 gola. Padyshim më i njohuri është het-triku në

përmbysjen e madhe të Tottenhamit në gjysmëfinalen e Ligës së Kampionëve në vitin 2019 ndaj Ajaxit në "Johan Cruyff Arena".

SHKURT

Gjilani arrin marrëveshje me Sinanin

Skuadra e Gjilanit ka nisur përgatitjet për sezonin pranveror në Superligën e Kosovës në futboll. Gjilanasit në muajt e fundit janë përballur me probleme të shumta financiare dhe ishte rrezikuar edhe pjesëmarrja në vazhdim të kampionatit. Tashmë "kuqebardhët" janë duke menduar edhe për transferime në këtë afat kalimtar të janarit. "Gazeta Enigma" mëson ekskluzivisht se Gjilani ka arritur marrëveshje me qendërbrojtësin e njohur Egzon Sinanin. 28-vjeçari së fundmi ka qenë pjesë e kampionit aktual, FC Ballkani. SC Gjilani në sezonin vjeshtor është pozicionuar në vendin e katërt me 27 pikë të mbledhura, aq sa ka edhe Prishtina e cila zë vendin e tretë.

Trajneri i Bayernit: Jemi të detyruar të blejmë një portier

Bayern Munchen është i detyruar të nënshkruajë me një tjetër portier në merkaton e dimrit pas lëndimit të portierit Manuel Neuer. "Gardiani" i njohur pësoi një dëmtim të rëndë duke bërë ski dhe do të mungojë për pjesën e mbetur të sezonit. Trajneri Julian Nagelsmann ka komentuar situatën e klubit "bavarez". "Asnjë klubi nuk i pëlqen ta japë portierin e tij, ne jemi të detyruar të nënshkruajmë me një portier të ri. Situata në tregun e transferimeve është komplekse sepse klubet e tjera po kërkojnë pozicione të caktuara. Kjo ishte e pritshme duke pasur parasysh mënyrën se si po shkojnë gjërat", ka deklaruar Nagelsmann.

Guardiola pas humbjes nga Southamptoni: Fitoi skuadra më e mirë

Manchester City është eliminuar nga Carabao Cup në fazën çerekfinale pasi Southamptoni i shkaktoi humbje me rezultat 2-0. Trajneri Pep Guardiola nuk përdori lojërë fjalësh pas këtij eliminimi të hidhur, por përgëzoi Southamptonin për këtë sukses. "Fitoi skuadra më e mirë. Nuk luajtëm mirë, mbi të gjitha, në pjesën e parë. Ka ndeshje që mund t'i nisësh keq, por mund t'i fitosh, por ne nuk e bëmë. Kjo ishte një humbje e shëmtuar. Kundërshtari ynë luajti më mirë. Nuk më mbetet gjë tjetër vetëm ta uroj", ka thënë Guardiola.

Milani eliminohet nga Kupa, Pioli: Është një zhgënjim i madh

AC Milan u eliminua nga Kupa e Italisë pasi pësoi humbje nga Torino (1-0) në kohën shtesë. Zhgënjimi ishte i madh të kuqezinjtë pasi për 50 minuta luajtën me një futbollist më shumë. "Është një zhgënjim i madh, më vjen keq. Ne u përballëm mirë me kundërshtarët tanë, por duhet të shfrytëzonim më mirë kohën shtesë. Kemi luajtur një lojë serioze, vendimtare, agresive dhe me cilësi. Dëshirojmë të jemi konkurrues në të gjitha garat që jemi. Tani duhet të rifillojmë me më shumë vendosmëri. E lashë të luajë De Ketelaere sepse është një lojtar i rëndësishëm për ne. Ai vërtet nuk ishte në rolin e tij, por Giroud u kthye nga Kupa e Botës dhe nuk pres që ai të luajë çdo tri ditë. Kjo mund t'i sjellë rezik për t'u dëmtuar. Të luash si qendërsulmues kundër Torinos nuk është e lehtë. Charles bëri një lojë cilësore dhe është e qartë se ne të gjithë prisnim një lojë vendimtare. Por nuk ishim në gjendje që të bënim një gjë të tillë", ka thënë Stefano Pioli, trajner i Milanit.



Kompania Rajonale e Ujësjesit
"Mitrovica" SH.A.

"Rr.Liqeni", p.n. 40000 Mitrovicë-Suhodoll



Konform me funksionet dhe kompetencat që parashihen Nenit 21, lidhur me nenin 17 të Ligjit për Ndërmarrje Publike (Ligji Nr. 03/L-087), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i Auditimit të KRU "Mitrovica" Sh.A., me seli në Mitrovicë-Suhodoll, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2022, vendosi të shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

Titulli i punës : Zyrtar Kryesor Financiar

Vendi: Mitrovicë-Suhodoll

Ndërmarrja: Kompania Rajonale Ujësjesit, Mitrovica, Sh.A.

I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv të KRU "Mitrovica" Sh. A, Mitrovicë

Mandati: 3 vite- me mundësi vazhdimi

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (k) dhe (l) dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Të ketë diplomë universitare Master të Fakultetit Ekonomik ose ekuivalente dhe përvojë të konsiderueshme nga fusha e financave dhe/ose kontabilitet.
- Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Të ketë së paku 5 vjet përvojë punë në menaxhim të dëshmuar në financa dhe/ose kontabilitet;
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional,
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim,
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi,
- Të mos jetë i dënuar ose nën hetime,
- Njohurit në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), sipas udhëzimeve të Federatës ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) do të jenë përparësi;

Funksioni dhe përgjegjësitë kryesore të Zyrtarit Kryesor Financiar të përcaktuara me Statutin e kompanisë:

Zyrtari Kryesor Financiar i Shoqërisë ("ZKF") do të menaxhojë, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e KE, çështjet financiare të Shoqërisë, varësisht prej kufizimeve të vëna nga Këshilli i Drejtorëve- do të ketë autoritetin e lidhjes së të gjitha kontratave financiare për Shoqërinë, dhe do të jetë përgjegjës që:

Të mirëmbajë llogaritë e Shoqërisë të azhuruara dhe të sakta;

Të themelojë dhe udhëheqë të gjitha kontrollet e brendshme financiare, duke përfshirë blerjet, pranimet e parave të gatshme, dhe pasuritë themelore. Të monitoroj llogaritë e pagueshme dhe të koordinojë pagesën e faturave dhe blerjet speciale. Të rishikojë shpenzimet e të punësuarve për të siguruar pajtueshmërinë me politikat e Shoqërisë dhe buxhetin para pagesës së tyre;

Të përgatisë të dhënët e Shoqërisë për auditim në fund të vitit;

Të rishikoj, të arrij marrëveshje për prokurime dhe mirëmbajtje të të gjitha bizneseve të ndërlidhura me politikat e sigurimit;

Të koordinojë funksionet tjera të biznesit, siç janë dhënia me qira e objekteve dhe pajisjeve, si dhe të bëjë blerje me KE dhe zyrën apo funksionin e prokurimit të Shoqërisë;

Menaxhojë thesarin e Shoqërisë;

Të vendos dhe përgatitë buxhetet; dhe

Çfarëdo tjetër detyre e përcaktuar nga ana e KE.

Detyrat dhe përgjegjësitë e ZKF-së janë:

- Përgjigjet për të gjitha veprimet financiare të kompanisë në regjionin që e mbulon kompania.
- Obligohet për bashkëpunim të ngushtë me: Bordin e Drejtorëve dhe Komisionin e Auditimit, Kryeshefit Ekzekutiv, Drejtorin Komercial, Drejtorin Teknik dhe Menaxherët e Departamenteve,
- Ka për detyrë të nxjerr dhe planifikojë buxhetin, të vëzhgojë mospërputhjet. Të përcjellë regjistrimin në kontabilitet, të japë këshilla të gjithë personelit të sektorëve për veprime efektive. Të vëzhgojë-përcjellë qarkullimin e parasë së gatshme dhe transaksionet bankare,
- Përmes Menaxherit Ekzekutiv dhe personelit tjetër, të udhëheqë me ndërmarrjen përpara palëve të interesit (Bordi i Drejtorëve-Aksionari, Komuna, Donatorët). Të sigurojë llogari sipas nevojës që kërkohen për raportimin e ndërmarrjes,
- Përmes personelit nënrenditës, posaçërisht menaxherit ekzekutiv të shitjes, dhe në bashkëpunim të ngushtë me menaxherin ekzekutiv të shërbimit të konsumatorëve, të udhëheqë dhe kontrollojë të hyrat nga: Faturimi dhe inkasimi; mirëmbajtjen e të dhënave të konsumatorëve,

- Të këshillojë përmes Kryeshefit Ekzekutiv në Bordin e Drejtorëve, lidhur me progresin financiar të ndërmarrjes, planet e tanishme të biznesit dhe planet periodike dhe afat gjatë të shpenzimeve dhe aktiviteteve, fluksin e të hyrave dhe shpenzimeve,
- ZKF-zotëron planin e aktivitetit të Kompanisë të specifikuar në çdo Plan të Biznesit,
- Kërkon, propozon, gjen dhe zbaton metoda dhe mënyra për të ndërruar dhe përmirësuar metodat e punës me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të konsumatorëve,
- Siguron se i gjithë personeli është i informuar me synimet dhe misionin e përbashkët të departamenteve, përkatësisht tërësisë së kompanisë,
- Udhëheqë personelin nënrenditës për të siguruar shërbime efektive,
- Vazhdimisht kërkon metoda dhe mënyra për të ndërruar dhe përmirësuar qasjen ndaj punës me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të konsumatorëve,
- Për punën që kryen i përgjigjet Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Paga: Në pajtim me „Rregulloren për ndarjen e të ardhurave personale të KRUM-së „ të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Procedura e aplikimit:

Aplikacioni duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Letër motivimi,
- Deklarata nën betim,
- Diploma e Universitare (kopja e noterizuar, kurse diplomat nga universiteti jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmia nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmitë e eksperiencës në punë / referencat (duke pasur të shënuar email-adresat dhe numrat kontaktues),
- Certifikatat (nëse posedon) lidhur me njohurit në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), sipas udhëzimeve të Federatës ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK).

Aplikacioni dhe Deklarata nën Betim mund të merren në ueb-faqen e Kompanisë në adresën: <http://www.kru-mitrovica.com/kerko-me-shume/konkurset/>. Aplikacionet dhe dokumentet përcjellëse duhet të dorëzohen të skenuara ose në formatin .pdf në email adresën: rekrutimi@kru-mitrovica.com. Konkursi do të jetë i hapur 30 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit. Aplikacionet e pranuar pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

KRU "Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë-Suhodoll.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 datë 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 12.01.2023 bënë shpallje publike për dhënie me qira të pronës së paluajtshme me qira.

Shpallje Publike

T-23-01

Qëllimi i ofertës:	Dhënie me qira e një pjese të objektit Metalurgjinë e Zinkut.
Kriteret e Dhënies:	Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë
Data e shpalljes:	12.01.2023
Sqarimi:	deri me 26.01.2023
Kërkesa për pjesëmarrje:	Data(t) për kërkesës deri: 26.01.2023 Behet në e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e Divizionit të shitjes dhe qirasë.
Dorëzimi i ofertave:	Dorëzimi i ofertave bëhet në formë fizike (zarf të mbyllur)
Afati i fundit i dorëzimit:	27.01.2023 në 11:00
Vendi i dorëzimit:	Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A. Parku Industrial, Mitrovicë

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: <i>Trepça sh.a.</i>		
Adresa postare: <i>Parku industrial</i>		
Qyteti: <i>Mitrovicë</i>	Kodi postarë: <i>40000</i>	Shteti: <i>Kosovë</i>
Kontakti: <i>Burim HAJDINI</i>		Telefoni: <i>+383 (0) 28 538 050</i>
Email: <i>sales@trepcacorporation.com</i>		Faksi: <i>+383 (0) 28 539 202</i>
<i>www.trepcacorporation.com</i>		



Kompanija Regionalnog Vodovoda
"Mitrovica" D.O.,
"Ul."Jezero", b.b. 40000 Mitrovica-Suvi Do

U skladu sa funkcijama i ovlašćenjima prdviđenim Članom 21 u vezi sa članom 17 Zakona o Javnim Preduzećima (Zakon Br. 03/L-087), izmenjen i dopunjen Zakonom Br.04/L-111 i Zakonom br. 05/L-009) za Zakona o Javnim Preduzećima, Upravni Odbor i Komisije za Reviziju KRV "Mitrovica" D.O., sa sedištem u Mitrovici-Suvi Do, na sednici održanoj dana 27.12.2022 godine, odlučio da raspiše ovaj:

JAVNI KNKURS

Radno Mesto : Glavni Finacijski Zvaničnik

Mesto: Mitrovica-Suvi Do

Preduzeće: Kompanija Regionalni Vodovod., Mitrovica., D.D.

On Odgovara: Upravnom Odboru i Izvršnom Direktoru KRV „Mitrovica“ D.D. Mitrovica.

Mandat: 3 godine – sa mogućnošću produženja

Uslovi i zahtevane kvalifikacije:

Upravni Odbor želi da se obezbedi da svi potencijalni kandidati budu lica sa poznatim integritetom koji ispunjavaju uslove kvalifikacija prema članu 17.1., ispunjavaju kriterijume nezavisnosti prema članu 17.2. tačka (d), (f), (k) i (l) i imaju potrebno stručno iskustvo i zahtevano školovanje za navedenu poziciju.

Osim ovih opštih uslova, kandidati treba da ispunjavaju i ove posebne uslove:

- Da ima Univerzitetsku diplomu Master Ekonomskog Fakulteta ili ekvivalent i značajno iskustvo u oblasti i/ili računovodstva.
- Diplome od stranih univerziteta teba da budu nostrifikovane od strane Ministarstva prosvete, Nauke i Tehnologije;
- Da ima najmanje 5 godina radnog iskustva u dokaznom menadžmentu i/ili računovodstvu;
- Da ima visok moralni i profesionalni integritet,
- Da ima dokazne sposobnosti upravljanja,
- Poznavanje stranih jezika je prednost,
- Da ne bude osuđen ili pod istragom,
- Znanje u tumačenju Međunarodnih Računovodstveni Standarda (MRS) i Međunarodnih Standarda Finacijskog Izveštavanja (MSFI), prema uputstvima Međunarodne Federacije Računovođa (MFR) će biti prioritet;

Funkcionisanje i glavne odgovornosti Glavnog Finacijskog Zvaničnika određene Statutom Kompanije:

Glavni Finacijski Zvaničnik Društva (GFZ) će upravljati pod upravom i nadzorom IO, finacijske poslove društva, podležu graničenjima koja nameće Upravni odbor – imat će autoritet veze svih finacijskih ugovora za Društvo, i bit će odgovoran da:

Da održava račune Kompanije ažurnim i tačnim.

Da uspostavi i upravlja svim internim finacijskim kontrolama, uključujući nabavke, gotovinskog novca i osnovna sredstva. Da prati dugovanja i koordinira plaćanje računahna i posebne kupovine. Da pregleda troškove zaposlenih kako bi se osigurala uskladenost sa politikama kompanije i njihovim budžetom pre njihovih isplata.

Da pripremi podatke Kompanije za reviziju na kraju godine;

Da preispita postizanje sporazuma za nabavku i održavanje shih poslova vezanih za politikama obezbeđenja;

Da koordinira ostale funkcije poslovanja, kao što su izdavanje objekata i opreme pod zakum, kao i da vrši kupovinu za EK i kancelarijom ili funkcijom nabavke kompanije.

Da menadžita trezorom Kompanije;

Da odlučuje i pripremi budžete, i

I bilo koji drugi zadatak koji odredi EK.

Zadaci i odgovornosti GFZ su;

- Odgovara za sve finacijske postuake kompanije u rgiji koju pokriva kompania. .
- Obavezuje se za usku saradnju sa: Upravni Odbor i Komisije za Reviziju, Izvršnim Direktorom, Komercijalnim Direktorom, Tehničkim Direktorom i sa rukovodiocima odeljenja.
- ma za zadatak da izradi i planira budžet, da prato neslaganja . Da prati registraciju u računovodstvu, da daje savete čitavom osoblju sektora za efektivne postuake. Da prati promet gotovog noca i bankarskih transakcija.
- Preko Izvršnog Direktora o ostalog osoblja, da rukovodi sa preduzećem pred stranama interesa (Bord Direktora-Akcionari, Opština, Donatori). Da obezbedi rakun po potrebi koji se zahtevaju za izveštavanje preduzeća.
- Preko podređenog osoblja, posebno izvršnog direktora prodaje, i u uskoj saradnji sa izvršnim direktorom usluga potrošača, da rukovodi i kontroliše prihode od: Fakturisanja i inkasiranja, odražavanje podataka potrošača.
- Da savetuje preko Glavnog Izvršnog Direktora u Upravnom Odboru, u vezi sa finacijskim progresom preduzeća, sadašnje planove poslovanja i periodične i dugoročne planove trokova i aktivnosti, tok prihoda i rashoda.
- GFZ-poseduje poslovni plan Kompanije specifikovane u vaki Plan

- Zahteva, predlaže, namazi i sprovodi metode i načine za promenu i popravku metoda rada sa namerom poboljšanja usluga potrošača.
- Obezbeduje da svo osoblje bude informisano sa namerama i zajedničkom misijom odelenj, odnosno celine kompanije,
- Vodi podređeno osoblje kako bi osigurali efikasne usluge,
- Stalno traži metode i načine da prometi i popravi pristup prema radu sa namerom popravljjanja usluga potrošača.,
- Za obavljeni posao odgovara Upravnom Odboru i Glavnom izvršnom Direktoru.

Plata: U skladu sa "Pravilnikom o raspodeli ličnih primarja KRVM" usvojeno od strane Upravnog Odbora. .

Procedura aplikacije:

Aplikaciji treba priložiti i sledeća dokumenta:

- CV-ja (Biografija),
- Kopija lisne karte,
- Motivaciono pismo,
- Izjava pod zakletvom,
- Univerzitetska Diploma (notarizovana kopija, dok diplome sa univerziteta van zemlje treba da budu nostrifikovane),
- Dokaz od i nadležnog suda da nije pod istragom, ne starija od 6 meseci,
- Dokazi o stručnoj spremi,
- Dokazi o radnom iskustvu/ reference (navodeći imejl adrese i kontakt brojeve)
- Sertifikati (ukoliko ih poseduje) u vezi sa Znanjem u tumačenju Međunarodnih Računovodstvenih Standarda (MRS) i Međunarodnih Standarda Finacijskog Izveštavanja (MSFI), prema uputstvima Međunarodne Federacije Računovođa (MFR).

Aplikacije mogu da se uzmu u direkciji Kompanije (ili veb-stranici Kompanije) na adresi : <http://www.kru-mitrovica.com/kerko-me-shume/konkurset/>. Aplikacija i prateća dokumenta treba da se predaju skenirano ili u .pdf formatu na mejl adresu: rekrutimi@kru-mitrovica.com

Konkurs će biti ovoren 30 dana od dana objavljivanja u sredstvima informisanja. Prijave podnete nakon roka se ne prihvataju, a nepotpune se odbijaju..

KRV"Mitrovica"D.D. Mitrovic-Suvi Do.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Mevlan Gashi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Elmedin Meleqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Valbon Mollakuqe shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Perparim Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Mihran Vasija shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

- Valmir Vitia shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "28 Nëntori" Prishtinë.

- Dafina Morina Ratkoc KK Rahovec shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SHFMU "4 Dëshmorët" Retkoc KK Rahovec.

- Meli Haxhikadija nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e QAM "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Besim Gjogja shpall të pavlefshme dëft5esën e sh.f.m.u. "Shaban Gola" Lipovec KK Gjakovë, nga kl. VI-IX.

- Nue Kita nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV të sh.m.ekonomike "Kadri Kusari.

- Ardian Lekaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Avni Hajdari shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Dy Dëshmorët " Pirane.

- Fesal Hyseni shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Altina Badalli shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Ali Ahmetaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Vjollce Fandaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmgi " Jeta e Re " Suhareke.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Kë shilli Gjyqësor i Kosovës, bazuar në nenin 39 paragrafin 3 Ligji Nr. 06/L - 054 Për Gjykatat, neni 6 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores nr. 03/2022 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Ekspertëve Gjyqësor dhe Vendimit KGJK-së nr. 497/2022 të datës: 27 dhjetor 2022, shpall:

**KONKURS PUBLIK PËR
ÇERTIFIKIMIN DHE EMËRIMIN E
EKSPERTËVE**

PARIMET E PËRGJITHSHME:

- Eksperti gjyqësor ushtron detyrat e tij në pajtim me rregullat dhe parimet e përgjithshme, përfshirë parimin e ligshmërisë, pavarësisë, paanshmërisë, konfidencialitetit dhe profesionalizimit;
- Eksperti gjyqësor zbaton udhëzimet sipas standardeve aktuale të shkencës, teknologjisë, përvijës dhe kujdesit të duhur;
- Përgatitja e mendimit dhe konstatimit të ekspertit duhet të jetë objektive dhe e paanshme. Gjatë përpilimit të ekspertizës, eksperti duhet t'i shmangët paragjykimet si dhe pranimit të përfitimeve tjera, përveç shpërblimit të përcaktuar me këtë rregullore;
- Eksperti duhet të deklarojë në fillim të procedurave gjyqësore se nuk ka ndonjë konflikt të mundshëm të interesit. Në rast se paraqitet konflikti i mundshëm i interesit ai/ajo duhet menjëherë të njoftojë të gjitha palët e interesuara dhe mund të tërhiqet nga caktimi i tij në rastin përkatës.

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ÇERTIFIKIMIN E EKSPERTËVE GJYQËSOR

- Per t'u certifikuar si ekspert gjyqësor, kandidati duhet t'i plotësojë kushtet e përgjithshme si në vijim:
 - të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - të ketë zotësi të plotë të veprimit;
 - diplomë universitare të vlefshme në Kosovë në fushën përkatëse;
 - të mos jetë i dënuar për veprë penale, në përjashtim të veprës penale të kryer nga pakujdesia;
 - të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale në fushën specifike apo të ngjashme; si dhe
 - të mos i jetë shqiptuar sanksioni ndalim i kryerjes së profesionit, detyrës apo veprimtarisë me vendim të plotfuqishëm të gjykatës;
- Perveç kushteve të përgjithshme, kandidati për t'u certifikuar ekspert gjyqësor duhet ta dëshmojë kompetencën dhe ekspertizën profesionale të tij/te saj me anë të kushteve specifike dhe mbështetëse, si në vijim:
 - Kualifikime profesionale që i ka arritur kandidati dhe që janë relevante për fushën e ekspertizës;
 - Trajnime dhe kurse të vecanta në të cilat kandidati ka marrë pjesë dhe që janë relevante për fushën përkatëse të ekspertizës;
 - Çmime, botime ose përvoja mësimore relevante për fushën e ekspertizës; dhe
 - Përvojë dhe aftësi profesionale të kandidatit, relevante për fushën e ekspertizës.
- Përjashtimisht nga dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, si ekspert gjyqësor mund të angazhohet edhe personi i cili ka njohuri në fushat specifike për të cilat mungojnë ekspertët të diplomuar nga universitetet përkatëse.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM

- Kandidatët në pajtim me nenin 8 Rregulloren nr. 03/2022 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Ekspertëve Gjyqësor, duhet të dorëzojnë dokumentet si në vijim:
 - Aplikacionin e plotësuar me të dhënat e kërkuara;
 - Çertifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
 - Diplomë universitare përkatëse të vlefshme në Republikën e Kosovës;
 - Dëshminë mbi përvojën e punës përkatëse, të përcaktuar me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi;
 - Çertifikata shëndetësore për vlerësimin e aftësive psiko-fizike të kandidatit;
 - Çertifikatën nga evidenca penale, e lëshuar nga gjykata; dhe
 - Dokumentet tjera/dëshmitë e përcaktuara si në nenin 7 paragrafi 2 kësaj Rregullore.

MËNYRA E APLIKIMI

- Aplikacioni së bashku me dokumentet mbështetëse mund të dorëzohet në Këshill në formë fizike, përmes postës së rregullt ose postës elektronike, i cili regjistrohet dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e aplikacionit;
- Për secilin kandidat krijohet dosje e cila përmban të gjitha dokumentet e prezantuara nga kandidati. Komisioni për Vlerësimin e Aplikacioneve të Kandidatit për Ekspert Gjyqësor është përgjegjës për formimin, mbajtjen e dosjes dhe siguron kompletimin dhe përditësimin e saj deri në momentin e përmbylljes përfundimtare të procesit të emërimit;
- Kandidati në aplikacion cakton fushën e tij të ekspertizës për të cilën kërkon të certifikohet;
- Kandidati i cili aplikon për t'u certifikuar si ekspert gjyqësor në fushën e caktuar duhet të paguajë taksën prej **pesëdhjetë (50) euro**. Dëshmia për pagesën dorëzohet në momentin e aplikimit dhe nuk është e rimbursueshme.

FORMULARI I APLIKIMIT

- formulari mund të shkarkohet nga faja zyrtare e KGJK-së. (www.gjyqesori-rks.org)

- **Shkarko aplikacionin:**

MËNYRA E APLIKIMIT

Aplikacioni së bashku me dokumentet mbështetëse mund të dorëzohet në Sekretariatin e Këshillit Gjyqësor në Zyrën e pranimit dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e aplikacionit.

Kandidati i cili aplikon për t'u certifikuar si ekspert gjyqësor në fushën e caktuar duhet të paguajë taksën prej pesëdhjetë euro (50 €). Fletëpagesa merret në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, përkatësisht në Departamentin për Buxhet dhe Financa. Dëshmia për pagesën dorëzohet në momentin e aplikimit dhe nuk është e rimbursueshme.

AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE

- Afati për dorëzimin të aplikacionit është i hapur gjatë tërë vitit 2023 nga dita e publikimit.
- Sekretariati i KGJK-së, Rruga "Luan Haradinaj" nr. 133, Prishtinë, në Zyrën e Pranimit.
- 10000 Republika e Kosovës

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Qullat, Rr. Bajram Kelmendi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Su
dski savet Kosova, na osnovu člana 39 stav 3 Zakona br. 06 / L - 054 O sudovima, člana 6. stav 1. i 2. Pravilnika br. 03/2022 o proceduri za licenciranje, imenovanje, uslove, prava i obaveze i naknade sudskih veštaka i Odluke SSK-a br. 497/2022 od 27. decembra 2022. godine, objavljuje:

KONKURS ZA LICENCIRANJE I IMENOVANJE VEŠTAKA

OPŠTA NAČELA:

1. Sudski veštak vrši svoju dužnost u skladu da pravilima i opštim načelima, uključujući i načelo zakonitosti, nezavisnosti, poverljivosti i profesionalizma;
2. Sudski veštak primenjuje uputstva na osnovu aktuelnih naučnih standarda, iskustva i neophodne pažnje;
3. Izrada stručnog mišljenja i zaključka mora biti objektivna i nepristrasna. Prilikom sastavljanja veštačenja, veštak treba da izbegava predrasude, kao i prihvatanje drugih pogodnosti, osim naknade definisane ovim pravilnikom.
4. Veštak mora na početku sudskog postupka da izjavi da ne postoji potencijalni sukob interesa. U slučaju potencijalnog sukoba interesa on/ona mora odmah obavestiti sve zainteresovane strane i može povući svoje imenovanje u relevantnom slučaju.

OPŠTI USLOVI ZA LICENCIRANJE SUDSKIH VEŠTAKA

1. Da bi stekao zvanje sudskog veštaka, kandidat mora da ispunjava sledeće opšte uslove:
 - 1.1. da bude državljanin Republike Kosova;
 - 1.2. da ima punu poslovnu sposobnost;
 - 1.3. važeću univerzitetsku diplomu na Kosovu u relevantnoj oblasti;
 - 1.4. da ne bude osuđivan za krivično delo, osim za krivično delo učinjeno iz nehata;
 - 1.5. da ima najmanje tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u određenoj ili sličnoj oblasti; kao i
 - 1.6. da mu pravosnažnom sudskom odlukom nije izrečena zabrana obavljanja profesije, dužnosti ili delatnosti;
2. Pored opštih uslova, kandidat za sudskog veštaka mora da dokaže svoje veštine i stručnost kroz specifične i prateće uslove, i to:
 - 2.1. Stručne kvalifikacije koje je kandidat stekao, a koje su relevantne za oblast veštačenja;
 - 2.2. Posebne obuke i kurseve na kojima je kandidat učestvovao i koji su relevantni za odgovarajuću oblast veštačenja;
 - 2.3. Nagrade, publikacije ili nastavno iskustvo relevantno za oblast veštačenja;
 - 2.4. Iskustvo i stručne sposobnosti kandidata relevantne za oblast veštačenja;
3. Izuzetno od stava 1. i 2. ovog člana, kao sudski veštak može se angažovati i lice koje ima znanja iz određenih oblasti u kojima nedostaju veštaci sa završenim odgovarajućim univerzitetima.

POTREBNI DOKUMENTI ZA APLICIRANJE

1. Kandidati u skladu sa članom 8. Pravilnika br. 03/2022 o postupku za licenciranje, imenovanje, uslove, prava, obaveze i naknade sudskih veštaka, mora dostaviti sledeća dokumenta:
 - 1.1. Aplikacija popunjena sa potrebnim podacima;
 - 1.2. Uverenje o državljanstvu Republike Kosova;
 - 1.3. Univerzitetsku važeću diplomu u Republici Kosova;
 - 1.4. Dokaz o relevantnom radnom iskustvu, utvrđenom ovim pravilnikom i zakonodavstvom na s snazi;
 - 1.5. Zdravstveno uverenje o psihofizičkom stanju kandidata;
 - 1.6. Potvrda iz kaznene evidencije, izdate iz suda; i
 - 1.7. Druga dokumenta /dokazi utvrđeni kao u članu 7. Stav 2. ovog Pravilnika.

NAČIN APLICIRANJA

1. Aplikacija se zajedno sa pratećom dokumentacijom može dostaviti Savetu u štampanom obliku, koja se registruje i svakom kandidatu se dostavlja potvrda o prijemu aplikacije;
2. Za svakog kandidata se kreira fajl koji sadrži svu dokumentaciju koju je kandidat podneo. Komisija za ocenjivanje aplikacija kandidata za sudskog veštaka odgovorna je za formiranje, održavanje, dosijea, i stara se o njegovom popunjavanju i ažuriranju do trenutka konačnog konačnog završetka procesa imenovanja;
3. Kandidat u aplikaciji određuje njegovu oblast veštačenja za koju želi da se licencira;
4. Kandidat koji se prijavi za dobijanje licence sudskog veštaka u određenoj oblasti mora da plati taksu od **pedeset (50) evra**. Dokaz o uplati se dostavlja u trenutku prijave i ne naknađuje se.

OBRAZAC ZA APLICIRANJE

- Obrazac se može preuzeti sa zvanične stranice SSK-a. (www.gjvqesori-rks.org);

- Preuzmi aplikaciju:

NAČIN APLICIRANJA

Aplikacija se zajedno sa pratećom dokumentacijom može se dostaviti Sekretarijatu Sudskog saveta u Kancelariji za prijem i svakom kandidatu se dostavlja potvrda o prijemu prijave.

Kandidat koji konkuriše za dobijanje licence za sudskog veštaka u datoj oblasti mora da plati taksu od pedeset evra (50 €). Uplatnica se uzima u Sudskom savetu Kosova, odnosno u Odeljenju za budžet i finansije. Dokaz o uplati se dostavlja u trenutku prijave i ne naknađuje se.

ROK ZA PREDAJU APLIKACIJA

- Rok za dostavljanje prijave otvoren je tokom cele 2023. godine od dana objavljivanja.
- Sekretarijat SSK-a, Ulica "Luan Haradinaj" br. 133, Priština, u Kancelariji za prijem.
- 10000 Republika Kosova



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mishi pule

cilësi e garantuar

pa konservues